



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT VJETOR I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS

Nr. 9

Prishtinë, 2026

Tabela e përmbajtjes

HYRJE	3
I. POLICIA E KOSOVËS.....	7
II. QENDRAT KORREKTUESE DHE TË PARABURGIMIT	15
III. AZILKËRKUESIT DHE MIGRANTET E PARREGULLT	20
IV. INSTITUCIONET E SHËNDETIT MENDOR DHE TË KUJDESIT SOCIAL.....	27
V. AKTIVITETET DHE TAKIMET E MKP-SË ME INSTITUCIONET KOMPETENTE GJATË VITIT 2025	44
RAPORTET ME REKOMANDIM TË MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS GJATË VITIT 2025.....	59

Hyrje

Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 17, parasheh se Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (në vijim referuar si: MKP), në përputhje me Protokollin Opcional (OPCAT) të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, i cili hyri në fuqi më 22 qershor 2006. Protokollin Opcional përcakton se çdo shtet palë duhet të krijojë një mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Duke pasur parasysh se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, MKP-ja funksionon në bazë të vendimit të Avokatit të Popullit nga viti 2016. Ligji përcakton detyrat e MKP-së, si: vizita të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit, si dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Raporti i Aktiviteteve të MKP-së për vitin 2025 bazohet në të dhënat e mbledhura gjatë 73 vizitave të paparalajmëruara në stacionet e policisë, në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, në stacionet e policisë kufitare, në institucionet psikiatrike, në atë të azilit, në qendrën e mbajtjes për të huaj, si dhe shtëpitë e kujdesit social.

Raporti ofron një pasqyrë të aktiviteteve që synuan parandalimin e torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. Gjatë këtij viti u publikuan 6 raporte dhe u dhanë 51 rekomandime për mbrojtjen e personave të privuar nga liria ose personave me liri të kufizuar të lëvizjes. Ashtu si në vitet e kaluara, nuk u identifikua asnjë veprim që përbënte torturë. Megjithatë, u hapën 29 raste për hetime sipas ankesave dhe 13 raste sipas detyrës zyrtare.

Në vitin 2025, MKP-ja vizitoi 15 stacione policore dhe 27 qendra korrektuese dhe të paraburgimit, ku vërejti se disa ambiente për personat e privuar nga liria nuk përputheshin plotësisht me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në disa zona, mbikëqyrja përmes kamerave nuk ishte instaluar ose kishte dukshmëri të dobët. Instalimi i mbikëqyrjes përmes kamerave në të gjitha zonat e stacioneve policore dhe në qendrave korrektuese do të përfaqësonte një masë shtesë mbrojtëse kundër abuzimit të mundshëm, si dhe siguri shtesë për oficerët e policisë dhe stafin korrektues në rastet e akuzave të pabazuara për abuzim fizik, psikologjik ose trajtim çnjerëzor. Gjithashtu, sistemi i thirrjes emergjente (zilja) nuk ishte i instaluar në qendrat e ndalimit të stacioneve policore, çka përbën një mangësi serioze në aspektin e sigurisë dhe të reagimit të shpejtë në rast nevojë.

Gjatë vizitave në stacionet policore, ku renovimet kishin përfunduar ose ishin në fazën përmbyllëse, u vërejtën përmirësime të dukshme në kushtet e qëndrimit të personave të ndaluar. Këto përmirësime përfshinin ndriçimin natyral, ventilimin e mjaftueshëm, pajisjen me shtretër, dyshekë dhe batanije të reja, si dhe funksionalizimin e sistemeve të kamerave, duke respektuar privatësinë e personave të ndaluar.

Megjithatë, kushtet infrastrukturore në një numër të konsiderueshëm institucionesh mbetën të papërmirësuara, kryesisht për shkak të objekteve të vjetra, mungesës së renovimeve ose zhvillimit të punimeve që ende nuk kishin përfunduar.

Gjatë këtij viti u pranuan gjithsej 113 ankesa, nga të cilat 26 ankesa u vlerësuan si të pranueshme për hetim; asnjëra nga këto ankesa të pranueshme për hetim nuk ka të bëjë me pretendime për keqtrajtim.

Ndërsa, sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit hapi katër raste ex officio lidhur me pretendime për keqtrajtim nga ana e zyrtarëve policorë ndaj qytetarëve.

Situata në sistemin e burgjeve shënoi përparime të dukshme, si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe në ngritjen e nivelit të cilësisë së punës. Shërbimi Korrektues i Kosovës (në vijim: ShKK) në radhët e veta numëron 1 386 staf të uniformuar dhe 283 staf civil, profesional dhe mbështetës, të trajnuar dhe të përkushtuar për përmbushjen e misionit të ShKK-së, të angazhuar në 11 qendra korrektuese dhe të paraburgimit. Për gjetjet nga monitorimet u njoftuan menjëherë autoritetet përgjegjëse, të cilat reagues duke ndërmarrë veprimet e nevojshme, ndërsa për Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë u publikua raport me rekomandime.¹

Në kuadër të ShKK-së ofrohen programe për rehabilitim dhe riintegrim të personave të privuar nga liria, të cilat ndikuan në uljen e recidivizmit, krijuan kushte për arsimim të obligueshëm fillor dhe profesional për të burgosurit, si dhe mundësuan ofrimin e programeve adekuate për aftësi të ndryshme profesionale. Një rol të rëndësishëm luajti Njësia Ekonomike, e cila zhvillon aktivitetin e saj ekonomik në katër qendra korrektuese: Dubravë, Smrekonicë, Lipjan dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë. Lejimi i të burgosurve për të punuar jashtë institucionit korrektues u vlerësua si një aktivitet i domosdoshëm drejt risocializimit të suksesshëm dhe përgatitjes së tyre për t'u rikthyer në shoqëri si individë të përgjegjshëm dhe të dobishëm.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti pranoi gjithsej 119 ankesa nga të dënuarit dhe të paraburgosurit, prej të cilave 17 u vlerësuan si të pranueshme për hetim, ndërsa 102 u shpallën të papranueshme.

Në periudhën raportuese u vizituan 20 institucione të shëndetit mendor dhe të kujdesit social. Kapaciteti i shtretërve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike (në vijim: IPFK) vazhdon të mbetet problem, duke marrë parasysh numrin e madh të personave që kanë nevojë për hospitalizim aty. Çështja e statutit ligjor të IPFK-së vazhdon të mbetet e pazgjidhur, edhe pse Avokati i Popullit e ripërsëriti rekomandimin e njëjtë. Në Repartin B të IPFK-së nuk ka protokoll specifik ku evidentohen mjetet e kufizimit, ashtu siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, standardeve të KPT-së dhe Procedurave Standarde të Veprimit të IPFK-së. Stafi shëndetësor mori vetëm një trajnim bazik për kapje dhe kontroll të menaxhimit të rasteve të vështira dhe nuk u realizuan më trajnime të tilla për stafin. Kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Vërehej mungesë e materialeve didaktike, si letra, ngjyra për vizatime dhe mjete të tjera për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale. Aplikimi i vikendeve terapeutike, i cili mungoi ndër vite, nuk u përfshi në Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së. Në shumicën e rasteve, pacientëve nuk u jepej mundësia për dhënie të pëlqimit me shkrim ose për të ushtruar të drejtën për refuzim të trajtimit, gjendje që vazhdon të mbetet e njëjtë. Në anën tjetër, filloi një bashkëpunim më i mirë i gjykatave me IPFK-në, dhe pacientët forenzikë po marrin pjesë në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideron të nevojshme.

¹ https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/08/Avokati-i-Popullit_Raport_MKPT-_vizita-ne-QP_Mitrovice_compressed.pdf

Problem po paraqet ndërrimi i shpeshtë i stafit të sigurimit nga kompanitë private, të cilët nuk morën trajnime adekuate për ta menaxhuar këtë kategori të personave.

Në institucionet e vizituara të kujdesit social (shtëpitë me bazë në komunitet në Ferizaj, Kamenicë dhe Prizren) u evidentua se asnjëra nga këto shtëpi nuk ka Plan Individual të Kujdesit për rezidentët, ashtu siç parashihet në nenin 25 të UA MD-Nr.03/2025 për Strehimin Rezidencial.

Në Shtëpinë me Bazë në Komunitet (në vijim: ShBK) në Ferizaj, kushtet e akomodimit në përgjithësi nuk janë të mira. Në kuzhinë, dritaret janë të dëmtuara dhe nuk mbyllen, ndërsa depoja ku mbahet ushqimi ka lagështi dhe myk, gjë që nuk i plotëson standardet minimale për jetesë të kësaj kategorie. Në Prizren nuk u kryen renovime dhe në disa pjesë të objektit, si dyert dhe sanitaria, ka nevojë për intervenime. Ndërkaq, kushtet në Kamenicë ishin të kënaqshme.

ShBK-i në Kamenicë posedon regjistra të veçantë, si p.sh. regjistra të incidenteve, shqetësimeve, terapisë, aktiviteteve dhe vizitave mjekësore. Ndërkaq, në ShBK-in në Ferizaj dhe në Prizren nuk ka regjistra të tillë, për çka Avokati i Popullit inkurajon udhëheqësit e ShBK-ve të tjera të marrin shembull nga ShBK-ja në Kamenicë dhe t'i unifikojnë procedurat në të gjitha shtëpitë.

Në institucionet ku mbahen azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt, u vizituan Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë (QPPM), Qendra për Azil (QA) dhe Qendra për Mbajtjen e të Huajve (QMH). Po ashtu, u monitorua kthimi me forcë nga Zvicra, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Nga të gjeturat e vizitës në QPPM rezultoi se nuk ka staf të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e migrantëve të akomoduar. Qendra nuk posedon udhëzues për funksionimin, të përcaktuar sipas Vendimit Nr. 0490/2022 të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të datës 24 qershor 2022. Për momentin, QPPM-ja përbëhet vetëm nga udhëheqësi i Qendrës, i cili kryen të gjitha shërbimet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës, ndërsa qendra ka nevojë për angazhimin e së paku një infermieri për dhënien e shërbimeve mjekësore për migrantët e akomoduar.

Gjatë vizitës në Qendrën e Azilit u vërejt se kushtet e akomodimit ishin në përgjithësi të një standardi shumë të mirë, për sa i përket hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Megjithatë, tri dhoma ishin jashtë funksionit për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi, për çka u njoftuam në fillim të takimit edhe nga drejtori.

Pavarësisht se Qendra e Azilit ofron kushte të pranueshme për familjet dhe fëmijët, u evidentuan shqetësime se ambienti nuk ishte i përshtatshëm për familjet, pasi ato ishin të vendosura në katin e dytë të kësaj qendre, ndërsa në katin e parë ishin të vendosur meshkujt beqarë. Kjo vendosje kufizonte lirinë e lëvizjes për fëmijët dhe nënat, ku shumicën e kohës e kalonin në dhomë, edhe pse nuk patën shqetësime nga banorët e tjerë. Duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve dhe nevojat e tyre për liri, siguri dhe zhvillim të shëndetshëm, Qendra ka nevojë për një ambient të veçantë dhe të përshtatshëm për familjet dhe fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe kujdesit për fëmijët në situata azili.

Pas vizitave të realizuara në këto qendra, për të gjeturat u publikuan raporte me rekomandime për QPPM-në² dhe QA-në³. Ndërsa në QMH⁴ u realizua aktivitet i përbashkët me UNHCR-në dhe CRPK-në.

Edhe gjatë këtij viti u angazhuam në mënyrë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar me misionet që veprojnë në Kosovë, duke marrë pjesë në shumë aktivitete të organizuara në kuadër të Rrjetit të MKP-së të Evropës Juglindore, Këshillit të Evropës, OSBE-së, EULEX-it dhe UNMIK-ut. Po ashtu, bashkëpunuam me institucione vendore, si: Inspektoratin Policor, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Shërbimin Korrektues, Drejtorinë Shëndetësore të Burgjeve, Shërbimin Sprovues dhe Panelin për Lirim me Kusht etj.

MKP-së i u sigurua qasje e pakufizuar në të gjitha institucionet e vizituara, si në informacionet, ashtu edhe në regjistrat e mbajtur në formë të shkruar ose elektronike, bazuar në mandatin ligjor.

² <https://oik-rks.org/2025/04/17/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-perkohshme-te-pritjes-per-migrante/>

³ <https://oik-rks.org/2025/10/28/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-azilit-ne-magure-lipjan/>

⁴ <https://oik-rks.org/2025/03/25/vizite-ne-qendren-per-mbajtje-te-te-huajve/>

I. POLICIA E KOSOVËS

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (në vijim: MKP) realizoi monitorime pa paralajmërim në qendrat e mbajtjes, në stacionet policore, në pikat e kalimit kufitar dhe në stacionet policore për mbikëqyrje të vijës së gjelbër të kufirit, me qëllim të vlerësimit të trajtimit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.

Të drejtat e personave të ndaluar nga Policia e Kosovës

Respektimi i të drejtave themelore të të arrestuarve dhe të të ndaluarve garantohej nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (në vijim: KPT), në Raportin e tij të 2-të të Përgjithshëm, të publikuar në vitin 1992, theksoi rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën), e drejta për të pasur një avokat dhe e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore)⁵.

Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.



⁵ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

Vizitat e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës në stacionet policore

MKP-ja realizoi gjithsej pesëmbëdhjetë (15) vizita në qendrat e mbajtjes dhe në stacionet policore.

Nr.	Institucioni / Lokacioni	Lloji i vizitës	Data
1	Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	31.01.2025
2	Stacioni Policor Mitrovicë – Veriu	Vizitë ad-hoc	13.03.2025
3	Stacioni Policor Zveçan	Vizitë ad-hoc	13.03.2025
4	Stacioni Policor Leposaviq	Vizitë ad-hoc	13.03.2025
5	Stacioni Policor “Jugu” në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	14.03.2025
6	Stacioni Policor “Veriu” në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	03.04.2025
7	Stacioni Policor në Gjakovë	Vizitë e përgjithshme	14.04.2025
8	Qendra e Ndalimit në Pejë	Vizitë përcjellëse	19.05.2025
9	Stacioni Policor Malishevë	Vizitë e përgjithshme	26.05.2025
10	Stacioni Policor Rahovec	Vizitë e përgjithshme	26.05.2025
11	Qendra e Ndalimit në Prizren	Vizitë përcjellëse	28.05.2025
12	Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	08.07.2025
13	Stacioni Policor Suharekë	Vizitë ad-hoc	11.07.2025
14	Stacioni Policor në Gjiilan	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
15	Stacioni Policor në Kamenicë	Vizitë ad-hoc	17.10.2025

Trajtimi

MKP-ja realizoi intervista me disa persona që ndodheshin në mbajtje në disa prej stacioneve policore të lartcekura. Gjatë këtyre intervistave nuk u pranua asnjë ankesë lidhur me trajtimin ose mosrespektimin e të drejtave të tyre. Përkundrazi, disa nga të ndaluarit pohuan se zyrtarët policorë i trajtuan në mënyrë profesionale dhe korrekte në qendrat e ndalimit.

Gjatë vitit 2025 pranua gjithsej 108 ankesa, nga të cilat 26 u vlerësuan si të pranueshme për hetim. Asnjëra nga këto ankesa të pranueshme nuk ka të bëjë me pretendime për keqtrajtim; kryesisht, ankesat lidhen me mospranim në punë pas konkursit, mosavancim, mosdhënie të përgjigjes nga ana e autoriteteve përkatëse, ose çështje të tjera që nuk hyjnë në mandatin e MKP-së.

Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare, hapi 5 raste ex officio lidhur me pretendime për keqtrajtim nga ana e zyrtarëve policorë ndaj qytetarëve.

Rastet e trajtuara, janë si në vijim:

Rasti 26/2025, Ex officio, lidhet me pretendimet për sjellje joprofesionale dhe abuzim të autoritetit nga ana e anëtarëve të Policisë së Kosovës ndaj V. D., bazuar në informacionin e publikuar në portalin Kossev. Sipas raportimit të portalit, gjatë një kontrolli rutinë të automjetit në fshatin Soçanicë, Komuna e Leposaviqit, anëtarë të Njësiave Speciale të Policisë së Kosovës e nxorrën V. D. nga automjeti dhe e rrahën pa arsye të justifikueshme, në prani të pasagjerit.

Avokati i Popullit, lidhur me rastin në fjalë, kontaktoi Inspektoratin e Policisë së Kosovës (në vijim: IPK) për të kërkuar informacione dhe u njoftua se hetimet janë duke u zhvilluar dhe se do të njoftohet për rezultatin përfundimtar të hetimit. Për këtë arsye, Avokati i Popullit nuk procedoi më tej rastin.

Rasti 841/2025, Ex officio, bazohet në informacionin e publikuar në portalin “Bota Sot”, ku theksohet: *“Arrestohet polici në Prizren për tejkalim të autorizimeve dhe dhunë ndaj qytetarit”*.

Avokati i Popullit komunikoi me IPK-në dhe PK-në, ku u konstatua se pati tejkalim të autorizimeve nga zyrtarët policorë, dhe rasti u procedua për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Rasti 842/2025, Ex officio, bazuar në informacionin e publikuar nga Klan Kosova TV, me titull: *“Momenti kur policët keqtrajtojnë të dyshuarin gjatë arrestimit në Klinë”*.

Avokati i Popullit, edhe për këtë rast, komunikoi me IPK-në dhe PK-në, ku u konstatua se pati tejkalim të autorizimeve nga zyrtarët policorë. Rasti u procedua për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë Themelore në Pejë, e cila ngriti aktakuzë ndaj zyrtarëve policorë të përfshirë në këtë rast.

Rasti 850/2025, Ex officio, bëhet fjalë për një rast të hapur në bazë të dy informatave të publikuara në media, përkatësisht nga Klan Kosova TV: *“Vdekja e të riut nga Lipjani – çfarë dihet deri tani”*; dhe portali Kallxo.com: *“Vdekja e 27-vjeçarit në Lipjan: këta janë zyrtarët policorë të suspenduar”*.

Avokati i Popullit komunikoi me IPK-në, ku u njoftua se zyrtarët policorë u suspenduan nga vendi i punës. Rasti është ende duke u hetuar, ndërsa autoritetet kompetente janë në pritje të raportit nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Rasti 840/2025, Ex officio, rast i hapur në bazë të lajmit të publikuara në media, përkatësisht nga portali Sinjali: *“Ky është personi që dyshohet se u vetëngulfatë në qelinë e ndalimit në Suharekë”*.

Pas veprimeve të ndërmarra, u njoftuam nga IPK-ja se zyrtarët policorë kujdestarë kryen shkelje të rëndë disiplinore, ndaj të cilëve u ndërmorën masa nga Policia e Kosovës (PK).

MKP-ja vizitoi Qendrën e Ndalimit në Suharekë, me ç’rast siguroi informatat dhe është duke e trajtuar rastit.

Kushtet fizike në stacionet policore të vizituara

Bazuar në Procedurat Standarde të Operimit (PSO), qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e KPT-së, duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Gjatë vizitës pa paralajmërim në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, MKP-ja konstatoi se nuk ishin bërë përmirësime në kushtet infrastrukturore dhe të punës, pasi ndërtimi i qendrës së re është ende në proces, duke u ndikuar nga kushtet atmosferike dhe dinamika e punimeve të kompanisë ndërtimore. Aktualisht funksionojnë vetëm dy qeli; në rastet e mbipopullimit, personat e ndaluar transferohen në qendrat e tjera të mbajtjes në Drenas, Graçanicë, Podujevë dhe Lipjan.

Ekipi konstatoi se personat e ndaluar informohen për të drejtat e tyre. Megjithatë, u evidentuan mungesa të materialeve higjienike, si dhe probleme me furnizimin e stafit me uniforma dhe çizme. Përrjashtim bën vetëm gjenerata e re e stafit, e cila u furnizua rregullisht me veshmbathje.

Me ftesë të Komandantit, ekipi realizoi vizitë në Stacionin Policor të Mitrovicës – Veri, në atë të Zveçanit dhe të Leposaviqit. Qëllimi i vizitës ishte njoftimi nga afër me planifikimet dhe

zhvillimet e rinovimeve në proces, si dhe vlerësimi i përgjithshëm i kushteve ekzistuese përpara përfundimit të punimeve. Në takimin e realizuar në Stacionin Policor të Mitrovicës – Veri morën pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, OSBE-ja dhe Policia, ku u diskutuan gjithashtu çështje të tjera që lidhen me punën e institucioneve.

Në Stacionin Policor të Zveçanit dhe të Leposaviqit, renovimet ishin në fazën përfundimtare. Në Qendrën e Ndalimit në Zveçan ishin tri dhoma (dy dhoma me nga dy shtretër dhe një dhomë me një shtrat), ndërsa në Leposaviq ishin katër dhoma (dy dhoma me nga dy shtretër dhe dy dhoma me nga një shtrat). Qendrat e lartëpërmendura kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe ventilim, ishin të pajisura me dyshekë dhe batanije të reja, sistemi i kamerave ishte funksional dhe sigurohej respektimi i privatësisë së personave të ndaluar. Në Stacionin Policor në Mitrovicë – Veri, Qendra e Mbajtjes nuk ishte aktive gjatë vizitës, por sipas informatës së siguruar nga zëvendësudrejtori rajonal, Qendra është aktivizuar dhe gjatë vitit 2026 do të vizitohet nga MKP-ja.

Stacioni Policor “Jugu” në Prishtinë - është ndër stacionet me numrin më të lartë të pranimeve në rajon, ku personat e arrestuar qëndrojnë deri në gjashtë orë, pasi stacioni nuk posedon qendër të mbajtjes. Stacioni pati disa rinovime, edhe pse nuk ishin të mjaftueshme. Problemi i ngrohjes u rregullua, ndërsa kamerat e sigurisë ishin të vendosura në dhomën ku intervistohen personat dhe përdoren për rastet e veçanta me urdhër të prokurorit, si dhe në dhomën e dedikuar për rastet e dhunës në familje. Furnizimi me materiale të përgjithshme ishte i kënaqshëm. Megjithatë, u evidentuan mungesa të mëdha për printerë dhe automjete, gjë që e vështirëson procesin e punës. Janë vendosur për herë të parë hallka elektronike për viktimën dhe dhunuesin, por pajisjet kishin probleme teknike, duke shkaktuar zhurmë gjatë funksionimit.

Stacioni Policor “Veriu” në Prishtinë - aktualisht funksionon në një objekt të komunës në lagjen Arbëria, ku është vendosur përkohësisht. Ai nuk posedon qendër mbajtjeje; të arrestuarit qëndrojnë deri në gjashtë orë dhe intervistohen në zyrat e stafit policor. Stacioni është i furnizuar mirë me material të punës. Megjithatë, problemet me printerët po ndikojnë në efikasitetin e tij. Po ashtu, është evidentuar nevoja për më shumë mjete transporti për shkak të mbulueshmërisë së madhe territoriale.

Stacioni Policor në Gjakovë - ka qendër të mbajtjes me gjashtë dhoma ndalimi; gjatë vizitës ishin funksionale vetëm tri dhoma, të pajisura me kamera aktive dhe me ventilim. Qendra kishte nevojë për renovim, gjë që është rekomanduar nga Avokati i Popullit. Stacioni posedon gjithashtu një dhomë miqësore. Ashtu si në qendrat e tjera, u evidentuan vështirësi të vazhdueshme me pajisjet për fotokopjim dhe printim. Gjatë vizitës, ekipi intervistoi dy persona të ndaluar, të cilët deklaruan se u trajtuan mirë që nga momenti i arrestimit dhe nuk patën ankesa.

Stacioni Policor në Malishevë – këtu gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë, pasi nuk është ndërmarrë asnjë veprim për funksionalizimin e Qendrës së Ndalimit. Mirëpo, stacioni ka në dispozicion një Dhomë Miqësore, e financuar nga komuna, e cila ofron kushte të përshtatshme për intervistim dhe qëndrim të fëmijëve.

Stacioni Policor në Rahovec - ka qendër të mbajtjes me tri dhoma ndalimi (me nga dy shtretër), të pajisura me kamera vëzhgimi. Dhoma Miqësore është e rregulluar mirë dhe e përshtatshme për intervistim dhe qëndrim të fëmijëve. Sipas informatave të siguruar, stacioni

do të rinovohet në tërësi, duke u pajisur me ashensor, shkallë emergjente dhe parking. Edhe ky stacion ballafaqohet me problemin e pajisjeve për fotokopjim.

Stacioni Policor i Prizrenit - ka qendër të mbajtjes me pesë dhoma ndalimi, të pajisura me ventilim, kamera funksionale dhe dyshekë të rinj. Megjithatë, u evidentuan disa sfida, si mungesa e tualeteve brenda dhomave të ndalimit dhe problemet me fotokopjim. Gjatë vizitës, u intervistuan dy persona të ndaluar, të cilët nuk patën ankesa lidhur me trajtimin e tyre.

Stacioni Policor në Kamenicë - ka qendër të mbajtjes, e cila aktualisht është jashtë funksionit për shkaqe teknike, konkretisht për mungesë të pajisjeve kompjuterike, edhe pse qendra i plotëson të gjitha kushtet për punë dhe stafi është i trajnuar për të operuar aty. Stacioni posedon gjithashtu Dhomën Miqësore për rastet e dhunës në familje.

Stacioni Policor në Gjilan - ka qendër të mbajtjes, por gjatë vizitës nuk patëm qasje për shkak të disa punimeve pranë qendrës. Sipas informatave të siguruara, kushtet e akomodimit vazhdojnë të jenë jo të mira, me lagështi, myk dhe erë të pakëndshme për shkak të kanalizimit. Po ashtu, vazhdon problemi me pajisjet për fotokopjim dhe printim.

Duhet përmendur se, në të gjitha stacionet e lartcekura që vizitoi ekipi i MKP-së, u vërejt se asnjëherë në Dhomat e Ndalimit nuk ishte i instaluar sistemi i thirrjes (zilja). Për sa u përket broshurave ku janë të ilustruara të drejtat e njeriut, në disa qendra të ndalimit ato ishin të vendosura në mure, ndërsa në disa të tjera nuk ishin të vendosura. Lidhur me këtë, zyrtarët policorë pohuan se broshurat për të drejtat e personit të ndaluar vendosen vazhdimisht, por ato hiqen ose grisën nga vetë të ndaluarit.

Gjithashtu, duhet theksuar se edhe gjatë vizitave brenda këtij viti në stacionet e lartcekura, MKP-ja u njoftua se zyrtarët policorë hasin në vështirësi më të mëdha me personat përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor. Këto kategori e bëjnë shumë të vështirë menaxhimin e punës, pasi kërkojnë vëzhgim të pandërprerë për 48 orë, për shkak të rrezikut të tentimeve për vetëlëndim ose vetëvrasje. Këta persona paraqesin rrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për ta menaxhuar këtë kategori të ndaluarish.

Po ashtu, në të gjitha stacionet e lartcekura, MKP-ja mori ankesa nga zyrtarët policorë lidhur me kushtet e punës, si: stazhin e beneficuar, sëmundjet kronike të zyrtarëve, shujtat, inventarin e vjetruar, si dhe mungesën e materialit higjienik. Si shqetësim të përbashkët në të gjitha stacionet u evidentua mungesa e pajisjeve për fotokopjim ose prishja e shpeshtë e tyre, si dhe problemi me printerët, i cili pengon vazhdimisht procesin e punës. Problem i veçantë mbetet edhe mungesa e automjeteve; edhe ato që posedojnë stacionet janë shumë të vjetra dhe të demoluara.

Kujdesi shëndetësor

Për sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të arrestuar nga policia u ofrohen shërbime nga institucionet publike, si Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja nuk mori ankesa nga personat e intervistuar. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar u vërejt se policia evidentoi në dosjet personale të të ndaluarve njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Për më tepër, MKP-ja vërejtë një praktikë shumë pozitive në shumicën e stacioneve policore, ku të arrestuarit, qofshin të mitur apo të rritur, para se të dërgohen në ndalim, dërgohen për kontrollë mjekësore në qendrën më të afërt të Mjekësisë Familjare.

E drejta për telefonatë pas arrestimit

Për sa i përket telefonatës, si e drejtë themelore për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së të ndaluarit (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën), MKP-ja nuk mori ankesa lidhur me mosrespektimin e kësaj të drejte. Telefonata duhet të realizohet menjëherë në momentin e ndalimit, dhe jo pas disa orësh ose disa ditësh.

E drejta në avokat

E drejta për avokat, si e drejtë themelore, duhet të mundësohet menjëherë pas arrestimit, para çdo marrjeje në pyetje nga policia. MKP-ja nuk mori ankesa lidhur me shkelje të kësaj të drejte.

Ushqimi

Personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqimi brenda 24 orëve. Megjithatë, në shumicën e stacioneve policore të lartcekura, MKP-ja u njoftua nga zyrtarët policorë se të arrestuarit u ankuan lidhur me cilësinë e ushqimit, e cila shpesh konsiderohet jo e kënaqshme dhe e pamjaftueshme.

Parashtrimi i ankesave nga personat e arrestuar

Lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, personat e arrestuar kanë të drejtë të parashtrijnë ankesa në stacionin policor ku mbahen, në Inspektoratin Policor të Kosovës, si dhe tek organet e jashtme monitoruese, si MKP-ja dhe organizatat joqeveritare, të cilave u lejohet t'i vizitojnë vendet e privimit nga liria. Për të ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e IAP-së dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesave në mënyrë konfidenciale, në stacionet policore ku funksionojnë qendrat e mbajtjes janë vendosur kuti të ankesave, të cilat hapen nga personeli i caktuar i Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimi

Në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës (PK) dhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), si element i rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut, MKP-ja pati komunikim të vazhdueshëm, duke kërkuar informata dhe duke pranuar përgjigje lidhur me ankesat e qytetarëve.

Në mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, MKP-ja, së bashku me IPK-në, mbajti tetë tryeza vetëdijesimi për PK-në, ku u prezantuan mandatet e tyre dhe rëndësia e trajtimit të dinjitetshëm dhe human të qytetarëve.

Bashkëpunimi vazhdoi edhe me UNHCR-në dhe CRPK-në, ku u realizuan monitorime të përbashkëta në tetë pika kufitare. Pas monitorimeve, IAP-ja publikoi raport me rekomandime, dhe si rezultat u organizua tryezë diskutimi me Policinë Kufitare, ku u njoftua se një numër rekomandimesh janë implementuar bazuar në raportin e Avokatit të Popullit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit për stacionet policore

Nga vizitat e realizuara gjatë vitit 2025 në stacionet policore dhe në qendrat e ndalimit, Avokati i Popullit konstatoi se kushtet infrastrukturore në një numër të konsiderueshëm institucionesh mbeten të pa përmirësuara. Kjo ndodh kryesisht për shkak të objekteve të vjetra, mungesës së

renovimeve ose zhvillimit të punimeve që ende nuk janë përfunduar. Në disa stacione policore, qendrat e ndalimit janë pjesërisht ose plotësisht jashtë funksionit, gjë që detyroi transferimin e shpesh në qendra të tjera të mbajtjes të personave të ndaluar. Kjo rriti ngarkesën e punës për stafin policor të disa stacioneve dhe shkaktoi vështirësi operative dhe logjistike.

Në qendrat dhe stacionet ku renovimet përfunduan ose janë në fazën përmbyllëse, u vërejtën përmirësime të dukshme në kushtet e qëndrimit të personave të ndaluar. Këto përmirësime përfshijnë ndriçimin natyral dhe artificial, ventilimin e mjaftueshëm, pajisjen me dyshekë dhe batanije të reja, si dhe funksionalizimin e sistemeve të kamerave, duke respektuar privatesinë e personave të ndaluar. Megjithatë, në asnjë nga qendrat e ndalimit të vizituara nuk ishte i instaluar sistemi i thirrjes emergjente (zilja), çka përbën një mangësi serioze në aspektin e sigurisë dhe të reagimit të shpejtë në raste nevojë.

Nga shqyrtimi i dosjeve dhe intervistat e zhvilluara me personat e ndaluar, u konstatua se ata informohen për të drejtat e tyre ligjore dhe kanë qasje në shërbime mjekësore, përfshirë ndihmën e shpejtë dhe transportin në institucionet shëndetësore në raste urgjente. Nga personat e intervistuar nuk morëm ankesa për keqtrajtim fizik, ndërsa u vlerësua si praktikë pozitive dërgimi i të miturve dhe i personave madhorë për kontroll mjekësor para vendosjes në ndalim.

Avokati i Popullit konstatoi se mungesa e materialeve higjienike paraqet një problem të vazhdueshëm në disa stacione policore dhe qendra ndalimi. Furnizimi me uniforma dhe pajisje personale për zyrtarët policorë mbetet i pamjaftueshëm. Po ashtu, u evidentuan probleme të theksuara me pajisjet për fotokopjim dhe printim, të cilat shpesh janë jofunksionale ose mungojnë, duke ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e punës administrative dhe operative.

Në shumicën e stacioneve policore të vizituara u evidentua mungesa e mjeteve transportuese dhe gjendja e rënduar teknike e automjeteve ekzistuese, çka vështirëson kryerjen e detyrave policore, veçanërisht në stacionet me shtrirje të madhe territoriale; kushtet e punës për stafin policor rezultuan të vështira për shkak të mungesës së hapësirave adekuate, mbingarkesës së zyrave me numër të madh zyrtarësh dhe mungesës së pajisjeve bazë të punës, ndërsa zyrtarët policorë ngritën shqetësime edhe lidhur me të drejtat e tyre në raport me kompensimin për punën gjatë fundjavave, orëve të natës dhe mungesën e pagës së 13-të.

Gjatë vizitave u konstatua se trajnimet e brendshme zhvillohen rregullisht dhe përbëjnë praktikë pozitive, megjithatë stafi policor mbetet i pa trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për menaxhimin e personave me probleme të shëndetit mendor dhe të përdoruesve të substancave narkotike, të cilët shpesh paraqesin rrezik për vetëlëndim dhe për sigurinë e vetë stafit.

Ushqimi për personat e ndaluar ofrohet në përputhje me obligimet ligjore, por u raportuan shqetësime të vazhdueshme lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit të siguruar përmes kompanive kontraktuese.

Për sa i përket parashtrimit të ankesave, Avokati i Popullit konstatoi se në stacionet policore ku ekzistojnë qendra ndalimi janë vendosur kuti të ankesave nga Avokati i Popullit, të cilat garantojnë mundësinë e parashtrimit konfidencial të ankesave nga personat e ndaluar.

Megjithatë, gjatë periudhës së raportimit nuk u evidentua asnjë ankesë e depozituar në këto kuti.⁶

⁶ <https://oik-rks.org/2025/10/28/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-lidhur-me-vizitat-ne-stacionet-policore/> ; në këtë raport nuk janë të përfshira Qendra e Ndalimit në Gjilan dhe as ajo në Kamenicë.

II. Qendrat Korrektuese dhe të Paraburgimit

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e dhëna nga Ligji për Avokatin e Popullit, për të funksionuar si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, u realizuan gjithsej 27 vizita në qendrat korrektuese dhe në qendrat e paraburgimit.

Nr.	Institucioni / Lokacioni	Lloji i vizitës	Data
1	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë përcjellëse	23.1.2025
2	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
3	Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
4	Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
5	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	29.1.2025
6	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë përcjellëse	20.2.2025
7	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	27.2.2025
8	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë	Vizitë e përgjithshme	10.4.2025
9	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë e përgjithshme	24.4.2025
10	Qendra e Paraburgimit në Pejë	Vizitë ad-hoc	19.5.2025
11	Qendra e Paraburgimit në Prizren	Vizitë e përgjithshme	28.5.2025
12	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	19.6.2025
13	Qendra Korrektuese për të Mitur dhe Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan	Vizitë ad-hoc	16.7.2025
14	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	21.7.2025
15	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	22.7.2025
16	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë Ad-hoc	23.7.2025
17	Qendra e Paraburgimit në Pejë	Vizitë ad-hoc	2.8.2025
18	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	5.8.2025
19	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan	Vizitë ad-hoc	7.8.2025
20	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	15.8.2025
21	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	10.9.2025
22	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	14.10.2025
23	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan	Vizitë ad-hoc	14.10.2025
24	Qendra e Paraburgim në Gjilan	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
25	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	21.10.2025
26	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë ad-hoc	30.10.2025
27	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	14.11.2025

Qëllimi i vizitave ishte përcjellja e rekomandimeve të dhëna nga raportet e publikuara në vitet paraprake, intervistimi i të dënuarve dhe i të paraburgosurve, shqyrtimi i dosjeve për rastet e lëndimeve të pranuar përmes raporteve të Drejtorisë Shëndetësore të Burgjeve (DSHB), vlerësimi i kushteve të jetesës, hapja e kutive të ankesave, si dhe shqyrtimi i veprimeve të tjera që mund të rezultojnë në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së. Këtë vit u publikua raporti me rekomandime për Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, përmes të cilit u dhanë nëntë rekomandime⁷.

⁷ <https://oik-rks.org/2025/08/07/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-mitrovice/>

Gjatë këtij viti u pranuan 119 ankesa, nga të cilat 17 ankesa u vlerësuan si të pranueshme për hetim, ndërsa 102 u shpallën të papranueshme. Ankesat u pranuan në forma të ndryshme: përmes telefonit, intervistave, adresës elektronike, adresës postare, kutive të ankesave, nga familjarët, avokatët, si dhe në disa raste vetë zyrtarët e qendrave përcollën kërkesat e të dënuarve dhe të të paraburgosurve për takim me zyrtarët e MKP-së.

Institucioni	Numri i ankesave	Të pranueshme për hetim (Hapja e rastit)	Të papranueshme për hetim
QK Dubravë	25	2	23
QP Gjilan	24	1	23
QP Prishtinë	23	1	22
BSL	14	3	11
SHKK	10	3	7
QP Mitrovicë	6	1	5
QP Pejë	6	2	4
QP Prizren	4	1	3
QKM Lipjan	4	2	2
QKF Lipjan	3	1	2
QEK Lipjan	1	1	0
Totali	119	17	102

Ankesat e pranuar në Qendrat Korrektuese dhe në Qendrat e Paraburgimit kryesisht lidhen me: paraburgimin e paligjshëm, refuzimin e kërkesës për shfrytëzim të vikendeve, transferimet nga një qendër në një tjetër për arsye familjare, përdorimin e forcës, trajtimin jo të duhur mjekësor, kushtet e papërshtatshme të akomodimit, monitorimin e seancave, cilësinë dhe sasinë e ushqimit, angazhimin në punë brenda dhe jashtë institucioneve, kërkesat për sigurimin e letërnjoftimit dhe kartelës bankare, ndihmën për asistencë sociale, lirimin me kusht, si dhe mundësinë për dalje më të shpeshtë në ajër të pastër etj.

Janë pranuar 420 telefonata, në numrin pa pagesë, në numrat e Avokatit të Popullit ose në numrat mobil. Kemi zhvilluar 472 intervista individuale dhe të tjera grupe.

Në të gjitha rastet, palët u këshilluan për veprimet që duhen ndërmarrë, ndërsa autoritetet kompetente u njoftuan dhe ndërmorën veprime sipas përgjegjësi të tyre, duke vepruar në përputhje me rëndësinë dhe seriozitetin e ankesave.

Gjatë monitorimeve, vlerësohet çdo aspekt i jetës në burg, duke përfshirë: pranimin e të dënuarve, kujdesin shëndetësor, klasifikimin, mbipopullimin, higjienën, ushqimin, rutinën ditore dhe regjimin, sjelljen e të burgosurve në qendër, kontaktin me botën e jashtme përmes vizitave dhe telefonatave, masat disiplinore/vetmitë, mekanizmat e ankesave brenda qendrave, kantinat, arsimin, aktivitetet dhe trajnimet, punën, komunikimin me të dënuar të tjerë dhe me stafin, incidentet, lëndimet, vetëlëndimet dhe vdekjet, si dhe kushtet e akomodimit, përfshirë shtrojën, mbulojën, ndriçimin, ajrosjen, ngrohjen, tualetet/tushët, lavanderinë, depot, kuzhinën dhe punëtoritë etj. Çdo qendër ka rend të brendshëm shtëpiak, i cili rregullon këto aspekte dhe është i ndërtuar në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare.

Kërkesat dhe ankesat e pranuar i adresojmë te drejtori i qendrës së vizituar, drejtoria e përgjithshme dhe drejtori i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, menjëherë pas vizitës, në rast se vlerësojmë se ekziston shkelje e të drejtave të personave të privuar nga liria, rastet procedohen tutje për hetim.

Në kuadër të ShKK-së funksionojnë 11 qendra korrektuese me kapacitet total prej 2632 shtretërish, ndërsa në kohën e raportimit janë të akomoduar 1193 të dënuar dhe 545 të paraburgosur, çka nënkupton se në ShKK nuk ka mbipopullim.

Trajtimi

Trajtimi i të burgosurve është një detyrim ligjor dhe moral, i lidhur drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të njeriut, rehabilitimin, risocializimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. Gjatë vizitave në institucionet korrektuese, MKP-ja në përgjithësi vërejti një komunikim të mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Megjithatë, morëm pohime lidhur me përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve korrektues, për të cilat u hapën raste për hetim (dy pohime për keqtrajtim në BSL⁸, një në QK Dubravë⁹, një në QP Prishtinë¹⁰, një në QP Pejë¹¹, një në QKM Lipjan¹² dhe një në QEK Lipjan¹³).

Kushtet e jetesës

MKP-ja ndër vite konstatoi se Qendra e Paraburgimit në Pejë, ajo në Prizren dhe në Mitrovicë, si dhe Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, nuk i plotësojnë kushtet e akomodimit sipas ligjeve vendore dhe standardeve ndërkombëtare. Edhe pse filluan procedurat për rindërtimin e këtyre qendrave, u ndanë mjetet dhe u finalizuan projektet, ndërtimet ende nuk filluan. Ndërsa në qendrat e tjera rinovimet vazhduan në mënyrë të rregullt dhe kushtet e akomodimit mund të vlerësohen si të kënaqshme.

Regjimi dhe aktivitetet

Për sa u përket regjimit dhe aktiviteteve, vlerësohet se u rrit dukshëm numri i programeve dhe i aktiviteteve ditore, si dhe filloi të rritet numri i të dënuarve të angazhuar në punë jashtë institucionit.

Shëndetësia

Sistemi shëndetësor funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë që nga viti 2014, si shërbim i organizuar në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB), bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

MKP-ja ka bashkëpunim shumë të mirë me DShB-në, ku vazhdimisht e njofton për rastet e lëndimeve, qoftë ato të shkaktuara gjatë përlëshjeve ndërmjet të dënuarve, nga oficerët korrektues, si dhe për pranimet e reja dhe lëndimet e marra gjatë arrestimit nga Policia.

⁸ 535/2025 dhe 827/2025

⁹ 421/2025

¹⁰ 1437/2025

¹¹ 663/2025

¹² 673/2025

¹³ 1726/2025

17

DShB-ja hartoi Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), të harmonizuara me Rekomandimet e Këshillit të Evropës (KE) për shërbimet shëndetësore në burgje, të cilat shërbyen si model edhe për vende të tjera. Në të gjitha njësitë shëndetësore u kryen shërbime sipas PSV-ve, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë (24/7), nga stafi shëndetësor dhe konsultantët e angazhuar.

Shëndeti mendor vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore në vendet e privimit nga liria, pavarësisht se janë të angazhuar staf adekuat, përfshirë psikologë klinikë, psikiatër dhe staf tjetër mjekësor, meqenëse numri i rasteve të tilla është në rritje.

Sipas informatave të siguruara nga DShB-ja, nga gjithsej 214 raste të identifikuar me rrezik për vetëvrasje (në pranim), 15 nga ta tentuan vetëvrasje, ndërsa një rast përfundoi me vetëvrasje. Gjatë kësaj periudhe, funksionoi në mënyrë të kënaqshme Pavijoni D në Qendrën Korrektuese të Dubravës (QKD), ku u vendosën persona me nevoja të veçanta, çka ndikoi pozitivisht në trajtimin e rasteve të vështira për menaxhim. Në këtë pavijon u hospitalizuan rreth 133 të burgosur, ndërsa 104 prej tyre u liruan pas marrjes së trajtimit përkatës. Në kohën e raportimit, në trajtim mbetën edhe 53 persona.

Gjithashtu, sipas njoftimit të DShB-së, në të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve (NjShB) u kryen gjithsej 7793 konsultime psikiatrike dhe 7621 konsultime psikologjike. Furnizimi me barnat ishte i mjaftueshëm dhe nuk u morën asnjë ankesë të qëndrueshme lidhur me këtë aspekt. Kushtet higjienike dhe sanitare ishin të kënaqshme dhe nuk u regjistrua asnjë epidemi.

Gjatë këtij viti, numri i ankesave për trajtim shëndetësor ishte më i vogël, dhe në ato raste, kërkesat ose ankesat i drejtuan tek autoritetet kompetente, të cilat reagues menjëherë. Po ashtu, këtë vit filloi trajnimi i tërë stafit shëndetësor dhe korrektues lidhur me Protokollin e Stambollit, i cili ngriti lart shërbimit në përgjithësi.

Qëndrueshmëria e stafit paraqiti vështirësi në kryerjen e detyrave, pasi pati lëvizje të personelit, si rrjedhojë e mungesës së stimulimeve shtesë për punën në burgje, mospagimin e rrezikshmërisë dhe shtesave të tjera për karakteristikat specifike të punës.

DShB-ja dhe ShKK-ja, për performancën e mirë në risocializimin e të burgosurve, që ndikoi në uljen e recidivizmit në 12% përmes programeve shëndetësore, fituan çmimin “*Correctional Healthcare Winner*”.

Bashkëpunimi me institucionet vendore

Vazhduam bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë (Shërbimin Korrektues dhe Sprovues) dhe Ministrinë e Shëndetësisë (DShB), duke vendosur pika kontakti për komunikim efikas. Gjithashtu, mbajtën prezantime për gjeneratat e reja të oficerëve korrektues, duke theksuar jo vetëm detyrat e tyre formale, por edhe rëndësinë e trajtimit dhe respektimit të drejtave të të burgosurve. Roli i oficerit korrektues nuk kufizohet vetëm në hapjen dhe mbylljen e dyerve, por ka një ndikim të madh në trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të personave të privuar nga liria.

Mbajtëm kontakte të vazhdueshme me Panelin për Lirim me Kusht (PLK), duke u takuar dhe diskutuar kërkesat dhe ankesat drejtuar PLK-së, edhe pse numri i ankesave kundër këtij organi u zvogëluar dukshëm. Sipas informatave të siguruara, gjatë këtij viti raportues, PLK-ja pranoi gjithsej 843 kërkesa, nga të cilat 16 u bartën nga viti 2024. U shqyrtuan 689 kërkesa, ndërsa

154 raste mbetën të pashqyrtuara. Prej tyre, 369 kërkesa u aprovuan, 270 u refuzuan, për 54 raste u pushuan procedurat dhe 12 kërkesa u hodhën poshtë.

MKP-ja pranoi një ankesë nga një grup i të dënuarve me dënime afatgjata, të cilët pohuan se i përmbushën kushtet për aplikim për lirim me kusht. Ata theksuan se ishin të angazhuar në punë, patën sjellje të mira, nuk pësuan masa disiplinore, morën pjesë në të gjitha programet e ofruara nga qendra, kaluan vikendet me familjen dhe punuan jashtë institucionit. Megjithatë, kërkesat e tyre për lirim me kusht u refuzohen. Lidhur me këto shqetësime, MKP-ja takoi PLK-në adresoi ankesën.

Bashkëpunimi i mirë vazhdoi edhe me Shërbimin Sprovues, i cili njoftoi se gjatë vitit raportues pranoi gjithsej 1307 kërkesa, përfshirë masa dhe dënime alternative, si dhe persona të mitur të liruar në programin e përkujdesjes pas lirit. Prej tyre, 458 janë persona të rritur, ndërsa 849 janë të mitur.



III. Azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt

Avokati i Popullit, edhe gjatë këtij viti, përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) monitoroi vendet ku akomodohen azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt. Vizitat patën për qëllim vlerësimin e respektimit të të drejtave themelore të këtyre personave nga autoritetet e Republikës së Kosovës, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të inkuorpuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Të drejtat e azilkërkuesve dhe të migrantëve të parregullt

Të drejtat e të huajve në Kosovë janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet në fuqi dhe me konventat ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të kësaj Kushtetute¹⁴.

Ligjet dhe rregulloret me të cilat rregullohen të drejtat e të huajve në Kosovë janë si në vijim: Ligji Nr.06/L-026 për Azil¹⁵, Ligji Nr. 04/L-219 për të Huaj¹⁶, Rregullorja nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, Rregullorja nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt si dhe Drejtoria për Migrim në kuadër të Policisë së Kosovës.

Sipas rregulloreve dhe ligjeve të përmendura, si dhe standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, të huajt kanë të drejtë dhe garanci kundër keqtrajtimit, të drejtën në kushtet themelore të jetesës, kujdesin shëndetësor, ndihmën sociale themelore, ndihmën ligjore pa pagesë, të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë, lirinë e mendimit dhe të besimit fetar, të drejtën për punësim, si dhe të drejtën për trajnime profesionale.

Vizitat e MKP-së

Nr.	Institucioni / Lokacioni	Lloji i vizitës	Data
1	Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë në Vranidoll, Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	18.2.2025
2	Qendra për Mbajtjen e të Huajve në Vranidoll, Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	25.3.2025
3	Monitorimet e kthimit me forcë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.	Vizitë ad-hoc	8.4.2025
4	Qendra për Azil në Magure, Lipjan	Vizitë e përgjithshme	4.9.2025
5	Monitorimet e kthimit me forcë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.	Vizitë ad-hoc	4.9.2025
6	Monitorimet e kthimit me forcë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.	Vizitë ad-hoc	9.10.2025

¹⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16389>

¹⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë (QPPM)

Kjo Qendër është themeluar me Vendim Nr. 0490/2022 të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të datës 24 qershor 2022. Ndërsa, funksionimi i Qendrës është i rregulluar me *Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme*¹⁷.

Gjatë vitit Qendra u vizitua 2 herë së bashku me Komisaratin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe me Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CPRK), më të cilët Avokati i Popullit ka marrëveshje bashkëpunimi.

Procedurat e pranimit në QPPM

Në paragrafin 6 të Vendimit Nr. 0490/2022¹⁸ të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të datës 24 qershor 2022, potencohet: *“Pranimi, regjistrimi, profilizimi dhe referimi i migrantëve për në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë, bëhet nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) në kuadër të Policisë së Kosovës . Pra, pas pranimit dhe regjistrimit nga DMH-ja, dhe lëshimit të vërtetimit, akomodimi i migranteve bëhet nga zyrtarët e Qendrës.”*

Të drejtat e migrantëve në QPPM

Migrantët e akomoduar në QPPM kanë të drejtë për ndihmë mjekësore, ndihmë juridike falas, të drejtën e përkrahjes psiko-sociale sipas nevojës, të drejtën e përkthyesit në gjuhën amtare të migrantit apo në gjuhën të cilën ai e kupton, të drejtën e kryerjes së rriteve fetare, të drejtën për aktivitete sportive, të drejtën për qasje në internet 24/7, si dhe të drejtën për të parashtruar ankesë tek udhëheqësi i Qendrës, lidhur me kushtet e akomodimit dhe trajtimin e tyre.

MKP-ja vërejtí se secili migrant e nënshkruan deklaratën, përmes së cilës njoftohet për të drejtat e tij dhe përgjegjësitë. Deklarata është në tri gjuhë: arabisht, anglisht dhe shqip.

Trajtimi

Gjatë vizitës ekipi, intervistoi migrantët e pranishëm, të cilët pohuan se u trajtuan mirë dhe se nuk kanë ndonjë ankesë.

Sipas raportit vjetor, nga 1 janari deri më 31 dhjetor ishin të vendosur 802 migrantë, prej tyre 20 fëmijë të grup-moshave nga 0-18. Kryesisht migrantët ishin nga Maroku, Siria, Egjipti, Algjeria, Palestina, Afganistani dhe Iraku. Mesatarja e qëndrimit të migrantëve në Qendër është 7 ditë, maksimumi që mund të qëndrojnë është deri në 15 ditë.

Kushtet e akomodimit në QPPM

Gjatë vizitës në QPPM, ekipi i MKP-së vërejtí se kapaciteti i Qendrës ishte për 55 persona. Ndërsa kushtet e akomodimit ishin në nivelin e kënaqshëm. Qendra ishte e ndarë në dy blloqe: Blloku A - që shërben për akomodimin e burrave beqarë; ndërsa Blloku B - shërben për familjet dhe grupet e cënueshme. Aty ishin edhe dy dhoma të qëndrimit ditor, në cilat ka TV të instaluar me rrjet kabllor, si dhe hapësira e brendshme dhe e jashtme e Qendrës ishte mbuluar me Wi-Fi.

¹⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

¹⁸ Vendimi Nr.0490/2022 datë 24 qershor 2022

Ushqimi

Migrantëve u ofrohet ushqim nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa nga migrantët e akomoduar nuk patën ankesa.

Kujdesi shëndetësor

MKP-ja vërejti se shërbimet mjekësore për të huajt në këtë Qendër ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Ndërsa, Shërbimi i Refugjatëve Jezuit (JRS) ofron barna farmaceutike falas për migrantët dhe shërbimet psikologjike u ofrohen nga organizata joqeveritare Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Lidhur me shërbimet mjekësore, udhëheqësi i QPPM-së pohoi se kanë nevojë për të paktën një infermier për dhënien e terapisë si dhe ofrimin e ndihmës së parë mjekësore për migrantët. Këto shërbime kryhen nga udhëheqësi i Qendrës, që, në parim, paraqesin shkelje. Avokati i Popullit e adresoi këtë çështje në raportin me rekomandime.

Fëmijët

Gjatë vitit 2025, ishte i akomoduar një fëmijë i grup-moshës 0–13 vjeç, ndërsa nga grup-mosha 13–14 vjeç ishin 20 fëmijë/të mitur. Sipas udhëheqësit të QPPM-së, të miturit e pashoqëruar intervistohen në prani të punëtorit social, i cili vjen nga Qendra për Punë Sociale (QPS) e Komunës së Mitrovicës Veriore. Fëmija i pashoqëruar më pas vendoset në QPPM, së bashku me familjarët ose personat e afërt me të, me të cilët ka migruar.

Udhëheqësi i Qendrës pohoi se, lidhur me kategoritë e cënueshme, si të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e mundshme të trafikimit me qenie njerëzore, nuk ekziston asnjë trajnim apo udhëzues për kushtet e pritjes dhe vlerësimin e nevojave specifike për këtë kategori.

Kontaktet me botën e jashtme

Migrantët kanë të drejtë të dalin në ajër të pastër dhe nga Qendra në qytet, nga ora 7:00 deri në orën 22:00. Ndërsa, gjatë kohës së qëndrimit në Qendër, ata mund të zhvillojnë aktivitete sportive, kulturore apo fetare etj.

Migrantët, kur dalin jashtë hapësirave të Qendrës, evidentohen në regjistrat hyrje-dalje dhe pas kthimit ata kontrollohen nga zyrtarët policorë.

Migrantët vizitohen edhe nga Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), si dhe nga organizatat e ndryshme joqeveritare, si CRP/K, QKRMT.

Procedura e parashtrimit të ankesave

Migrantët kanë të drejtë t'i parashtrojnë ankesa udhëheqësit të Qendrës, lidhur me kushtet e pranimit dhe trajtimin e tyre në Qendër. Po ashtu, në dispozicion të migrantëve është një kuti e ankesave, e vendosur nga Qendra, ku ata mund t'i depozitojnë ankesat e tyre. Ankesa mund të parashtrohen gjithashtu edhe para përfaqësuesve të MKP-së, UNHCR-së dhe organizatave të tjera joqeveritare.

Gjatë vizitës, u shpërndanë broshura në gjuhët arabe, serbe dhe angleze, të cilat sqarojnë në detaje mandatin e MKP-së dhe të Avokatit të Popullit, si dhe mënyrën se si migrantët mund ta kontaktojnë institucionin.

Personeli i QPPM-së

Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti se stafi i QPPM-së tash për tash përbëhet vetëm nga udhëheqësi i Qendrës, i cili kryen të gjitha shërbimet e nevojshme për mbarrëvatjen e punës në Qendër edhe pse, sipas paragrafit 4 të nenit 23A të Rregullores për Funksionimi e Qendrës (ZKM) Nr. 03/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme¹⁹, parashihej që numri i të punësuarve në QPPM të jetë tre (3). Udhëheqësi pohoi se ka bërë kërkesa të vazhdueshme për plotësimin e stafit sipas rregullores, mirëpo, një gjë e tillë nuk u realizua nga MPB-ja deri me tani.

MKP-ja, duke u mbështetur në të gjeturat e vizitës në QPPM, publikoi raportin me rekomandime më 16 prill 2025, si dhe konstatoi si në vijim:

- Avokati i Popullit nga të gjeturat e vizitës konstaton se QPPM-ja nuk ka staf të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të migrantëve të akomoduar në Qendër.
- Avokati i Popullit konstaton se Qendra nuk posedon udhëzues për funksionimin e Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Vendimit Nr. 0490/2022 të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të datës 24 qershor 2022.
- Avokati i Popullit konstaton se në QPPM ka nevojë për angazhimin e të paktën një infermieri për dhënien e shërbimeve mjekësor për migrantët e akomoduar në Qendër.
- Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se ka nevojë për trajnime për stafin dhe të tjerët në fushën e migrimit, në mënyrë që migrantët të trajtohet sipas praktikave standarde ndërkombëtare.

Qendra për Azil

Qendra për Azil menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Rregullores (MPB) nr. 03/2018 për Funksionimin e Qendrës për Azil (tani e tutje: Rregullorja). Sipas nenit 4, të Rregullores, Qendra për Azil definohet si në vijim: *“Qendra organizohet dhe funksionon si institucion qendror, në kuadër të MPB/DSHAM, me seli në Magurë të Lipjanit. Qendra administrohet nga udhëheqësi i qendrës.”*

Ndërsa neni 26 i Ligjit nr. 06/L-026 për Azil përcakton të drejtat e aplikuesve, të cilët do të qëndrojnë në Kosovë, e të cilat janë: t’i ketë kushtet themelore të jetesës; kujdesin shëndetësor; ndihmën sociale themelore; ndihmën ligjore pa pagesë; të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë; të drejtën për lirinë e mendimit dhe të besimit fetar; të drejtën për punësim; dhe të drejtën për trajnime profesionale.

Për sa u përket të drejtave të lartcekura, MKP-ja gjatë vizitës nuk mori ankesa nga azilkërkuesit. Ekipi i MKP-së nuk vërejti shkelje të këtyre të drejtave të garantuara me Ligjin për Azil.

Trajtimi

MKP-ja gjatë vizitës nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim, si dhe nuk vërejti asnjë rast të keqtrajtimit nga ana e stafit të Qendrës.

Kushtet e akomodimit

¹⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

Gjatë vizitës në Qendrën për Azil, MKP-ja vërejti se kushtet e akomodimit janë në përgjithësi të një standardi shumë të mirë, në kuptim të hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Megjithatë, tri dhoma ishin jashtë funksionit për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi, për çka u njoftuam në fillim të takimit edhe nga drejtori.

Kujdesi shëndetësor

MKP-ja gjatë vizitës në Qendrën për Azil vërejti se shërbimet mjekësore për të huajt në këtë Qendër ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Po ashtu, një mjek është i angazhua nga Jezuit Refugee Service (JRS), e cila Qendrën e furnizon me barna dhe me materiale të tjera. Ekipi nuk mori ankesa nga azilkërkuesit për sa u përket shërbimeve mjekësore, ndërsa shërbimet psikologjike ofrohen nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Fëmijët

Gjatë vizitës në Qendër, ishin të akomoduar dy familje me fëmijë. Ndërsa nuk pati fëmijë të pashoqëruar e as viktime të identifikuar të dhunës dhe të torturës.

Brenda Qendrës ekziston këndi i lojërave për fëmijë, ndërsa fëmijët që i plotësojnë kriteret vijojnë mësimin fillor në shkollën fillore afër Qendrës.

Ekipi intervistoi një familje, e cila nuk pati ankesa lidhur me trajtimin dhe kushtet në Qendër. Megjithatë, shprehu shqetësime se ambienti nuk është shumë i përshtatshëm për familjet, pasi janë të vendosura në katin e dytë të Qendrës, ndërsa meshkujt beqarë qëndrojnë në katin e parë. Ky organizim i vendosjes kufizon lirinë e lëvizjes për fëmijët dhe nënat, ku shumicën e kohës e kalojnë në dhomë, edhe pse nuk kanë pasur shqetësime nga të banorët e tjerë.



Masat disiplinore dhe incidentet

Në rast se ndonjë nga aplikuesit e vendosur në Qendër manifeston dhunë ose sjellje agresive dhe rrezikon rendin dhe sigurinë në Qendër, ai mund të vendoset në dhomat e veçanta të Qendrës dhe menjëherë rasti paraqitet te organet kompetente (Policia). Sipas drejtorit, deri më tani kjo masë nuk u aplikua. Për përgjegjësinë për sigurinë në Qendër, përgjegjëse është kompania kontraktuese, e cila ofron sigurim fizik për objektet.

Personeli i Qendrës për Azil

Drejtori i Qendrës pohoi se sfidë mbetet mungesa e stafit në Qendër, pasi deri më tani u plotësuan vetëm katër pozita. Sipas Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme²⁰, parashihet që numri i të punësuarve në Qendër të jetë nëntë persona. Drejtori pohoi se ka bërë kërkesa të vazhdueshme për plotësimin e stafit sipas rregullores, mirëpo kjo nuk është realizuar nga MPB-ja deri më tani.

MKP-ja e Avokatit të Popullit, pas vizitës në Qendrën për Azil, publikoi raportin me rekomandim më 27 tetor 2025²¹ dhe konstatoi si në vijim:

- Edhe pse Qendra për Azil në Magurë ka kushte të mira akomodimi në aspektin e hapësirës, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes, tri dhoma aktualisht janë jashtë funksionit për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi. Për këto dhoma duhet të ndërmerret një intervenim i menjëhershëm, duke përfshirë rinovimin e kulmit për të eliminuar rrjedhjen e ujit dhe gëlqerosjen e dhomave, në mënyrë që të rikthehet funksionaliteti i tyre.
- Pavarësisht se Qendra për Azil ofron kushte të pranueshme për familjet dhe fëmijët, vendosja e familjeve në katin e dytë, shumë pranë katit të parë ku qëndrojnë meshkujt beqarë, krijon një situatë ku familjarët ndihen të kufizuar në lirinë dhe privatësinë e tyre, duke i detyruar të kalojnë shumicën e kohës në dhomat e tyre.
- Andaj Avokati i Popullit konstaton se duke respektuar interesin më të mirë të fëmijëve dhe nevojat e tyre për liri, siguri dhe zhvillim të shëndetshëm, Qendra ka nevojë për një ambient të veçantë dhe të përshtatshëm për familjet dhe fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe kujdesit për fëmijët në situata azili... Andaj, Avokati i Popullit konstaton se, duke respektuar interesin më të mirë të fëmijëve dhe nevojat e tyre për liri, siguri dhe zhvillim të shëndetshëm, Qendra ka nevojë për një ambient të veçantë dhe të përshtatshëm për familjet dhe fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve në situata azili.
- Po ashtu, Avokati i Popullit konstatoi nga të gjeturat e vizitës se Qendra për Azil nuk ka staf të mjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat e aplikuesve të akomoduar në Qendër. Andaj, konstaton se plotësimi i stafit duhet të bëhet sipas Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.²²

Qendra e Mbajtjes për të Huajt (QMH)

Avokati i Popullit, më 25 mars 2025, realizoi vizitë në QMH në Vranidoll, së bashku me shefin dhe stafin e UNHCR-së, si dhe me drejtorin e organizatës joqeveritare “Programi për të Drejta Civile në Kosovë” (CRPK).

Vizita pati për qëllim njohjen nga afër me funksionimin e QMH-së, si dhe me trajtimin e të huajve të vendosur aty nga autoritetet e Qendrës, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm

²⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

²¹ <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/10/organized-2.pdf>

²² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të inkorporuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ekipi u mirëprit nga udhëheqësi i QMH, i cili informoi të pranishmit mbi mënyrën e funksionimit të Qendrës dhe sfidat me të cilat përballlet ajo, duke sqaruar se Qendra funksionon në bazë të Rregullores²³ (MPB) Nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve. Në këtë rregullore janë përcaktuar procedurat e pranimit, regjistrimit, akomodimit dhe lëvizjes së të huajve të ndaluar brenda dhe jashtë QMH-së, si dhe janë rregulluar kushtet sanitare, higjienike, ushqimi, ndihma mjekësore, juridike dhe psikologjike, mbajtja e rendit dhe disiplinës, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e saj. Sfidë mbetet mungesa e mjekut, infermierit, psikologut dhe stafit administrativ. Megjithatë, të huajt e parregullt kontrollohen nga mjeku brenda 24 orëve pas pranimit, nga ekipi mjekësor i Urgjencës së Mjekësisë Familjare në Prishtinë.

Pas takimit, të pranishmit vizituan objektin e QMH-së, duke përfshirë Bllokun e Meshkujve dhe Bllokun e Femrave dhe Familjarëve, si dhe intervistuan të vendosurit aty. Gjatë vizitës nuk u paraqit asnjë ankesë për keqtrajtim. Në përgjithësi, kushtet që ofron Qendra janë të kënaqshme.

Sipas informatave të marra nga udhëheqësi i Qendrës, gjatë vitit 2025 në Qendër ishin të vendosur 39 të huaj, prej të cilëve 38 ishin meshkuj, ndërsa vetëm një ishte femër. Kryesisht, të huajt vinin nga Bangladeshi, Algjeria, Egjipti, Maroku, Nepali etj. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në Qendër ishte 98 ditë.

Ndërsa, gjendja mbetet e njejtë për sa i perket rekomandimit të Avokatit të Popullit për angazhim të stafit mjekësor dhe atij administrativ.



²³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18342>

Monitorimi i operacioneve të kthimit me forcë

Duke u mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Komisionit Kombëtar Zviceran për Parandalimin e Torturës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, të nënshkruar më 24 prill 2019, për monitorimin e përbashkët të operacioneve të kthimit me forcë ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës, gjatë këtij viti u monitoruan tri operacione të kthimit me forcë të shtetasve të Republikës së Kosovës nga autoritetet zvicerane, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.



Gjatë monitorimit të operacioneve, ekipi i MKP-së i intervistoi të kthyerit me forcë, të cilët nuk paraqitën ndonjë ankesë lidhur me trajtimin. Ata pohuan se u trajtuan në mënyrë korrekte dhe humane nga zyrtarët zviceranë, si dhe nga Policia e Kosovës. Të kthyerit u njoftuan për mandatin e MKP-së dhe të IAP-së përmes fletëpalosjeve, të cilat u shpërndanë gjatë monitorimit. Ekipi vëzhgoi gjithashtu procedurat e Zyrës së Migracionit, udhëzimet dhe informacionet që u janë ofruar të kthyerve për riatdhesim, si dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore.

Pas çdo monitorimi të kthimit me forcë nga Zvicra, MKP-ja përpiloi një raport njoftues për palën zvicerane, duke e informuar për gjithë ecurinë e monitorimit të të kthyerve me forcë.



IV. Institucionet e Shëndetit Mendor dhe të Kujdesit Social

Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës është themeluar dhe organizuar bazuar në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), duke u mbështetur në përvojat më të mira të shteteve evropiane.

Shëndeti mendor dhe çrregullimet mendore paraqesin një nga sfidat kryesore të shëndetit publik. Për këtë arsye, investimet në këtë fushë janë thelbësore. Avokati i Popullit vlerëson se pati zhvillime në fushën e shëndetit mendor, kryesisht në hartimin e dokumenteve përkatëse, shtimin e hapësirave në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë, riorganizimin e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese bazuar në nevojat aktuale, planifikimin për renovimin e plotë të repartit të Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP), ofrimin e shërbimeve me shtretër në Repartin e Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshentë, si dhe rritjen e kapaciteteve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Gjithashtu, pati zhvillime pozitive edhe në sistemin shëndetësor të burgjeve, përfshirë adaptimin e Pavijonit D në QKD për trajtimin e personave me nevoja të veçanta.

Përmes projektit të Këshillit të Evropës, përfituan DShB-ja, IPFK-ja dhe ISSh-ja, duke hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për IPFK-në dhe ISSh-në, si dhe duke rishikuar PSV-të e DShB-së. ISSh-ja, përmes këtij projekti, trajnoi gjithë stafin për Terapi Okupacionale dhe tani po punon për hartimin e Planeve Individuale të Trajtimin, si dhe për krijimin e një databaze për dosjet e rezidentëve.

Megjithatë, një sfidë për shëndetin mendor në Kosovë mbetet moszbatimi i Ligjit për Shëndetin Mendor, për shkak të mosnxjerrjes së akteve nënligjore nga Ministria, siç parashikon ligji, për të cilën Avokati i Popullit e adresoi ndër vite si problem. Sipas njoftimit të fundit nga kryesuesi i grupit punues të Ministrisë së Shëndetësisë, plotësimi ose ndryshimi i Ligjit për Shëndetin Mendor ende mbetet në nivel drafti.

Gjatë vitit 2025, ekipi i MKP-së realizoi vizita ad-hoc në repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) dhe në Psikiatrinë për Fëmijë dhe Adoleshentë, të cilat janë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë; në Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK); në departamentet psikiatrike të spitaleve regjionale në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Gjiilan; në dhomat e dedikuara për të burgosur në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren dhe në Pejë; në qendrat e shëndetit mendor në Prishtinë, Podujevë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren dhe Gjakovë; në Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB) në Ferizaj, Gjiilan, Prizren dhe Gjakovë; si dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK) në Kamenicë, Ferizaj dhe Prizren.

Bashkëpunimi

Gjatë vizitave në institucionet e shëndetit mendor, MKP-së iu ofrua bashkëpunim i plotë në të gjitha institucionet e vizituara dhe pati qasje të papenguar në të gjitha hapësirat, në dosjet shëndetësore, si dhe iu mundësua intervistimi me pacientët, pa praninë e personelit shëndetësor.

Të drejtat e personave me çrregullime mendore

Personat me çrregullime mendore gëzojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor²⁴ (LShM), Kodin Penal,

²⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.33/23, 2015, Prishtinë:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>.

Kodin e Procedurës Penale (KPP), Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), si dhe me instrumentet ndërkombëtare.

Gjatë vizitave në institucione të shëndetit mendor, në shumicën e institucioneve MKP-ja vërejtë se në korridore të institucioneve të vizituara janë vendosur Karta e të drejtave të pacientit dhe Karta e përgjegjësisë të pacientit²⁵, në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht).

Neni 15 i Ligjit për Shëndetin Mendor thekson se shërbimet e shëndetit mendor të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor menaxhohen në bazë të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK)²⁶.

Lidhur me Statutin (QRK) Nr. 01/2023, MPK-ja mori ankesë nga psikiatritë e spitaleve regjionale në komunat e Gjilanit, Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës, si dhe nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës, e cila u parashtrua kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me miratimin e Statutit Nr. 01/2023 për SHSKUK, i cili hoqi shërbimet psikiatrike brenda spitaleve regjionale.

Avokati i Popullit analizoi Statutin e përmendur më sipër dhe, më 3 korrik 2024, dërgoi në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 11 të Statutit (QRK) Nr. 01/2023 për SHSKUK-në. Në këtë kërkesë, Avokati i Popullit kërkoi nga gjykata që ta vlerësonte nëse paragrafi 1 i nenit 11 të Statutit është në pajtim me nenin 7, nenin 24, nenin 51, paragrafi 1, dhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese nxori aktgjykim²⁷, ku konstatoi se paragrafi 1 i nenit 11 të aktit të kontestuar është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 51 (Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale), në lidhje me paragrafin 1 të nenit 7 (Vlerat) dhe paragrafin 4 të nenit 92 (Parimet e Përgjithshme) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas këtij aktgjykimi, Statuti i ShSKUK-së plotësohet/ndryshohet duke shtuar Departamentet Psikiatrike në Spitalet e Përgjithshme, ashtu siç parashikon edhe Ligji për Shëndetin Mendor.

Nr.	Institucioni/Lokacioni	Lloji i vizitës	Data
1.	Qendra e Shëndetit Mendor (QShM) Gjilan	Vizitë përgjithshme	e 24 janar 2025
2	Shtëpia Integruese në Bashkësi (ShIB) Gjilan	Vizitë ad-hoc	24 janar 2025
3.	Qendra e Shëndetit Mendor (QShM) Prizren	Vizitë përgjithshme	e 27 janar 2025
4.	Shtëpia Integruese në Bashkësi (ShIB) Prizren	Vizitë përgjithshme	e 27 janar 2025
5.	Shtëpia me Bazë në Komunitet Prizren	Vizitë përcjellëse	28 janar 2025

²⁵ <https://aqhproject.org/wp-content/uploads/2020/08/Karta-e-te-Drejtave-te-Pacienteve-ne-Kosove.pdf> Ministria e Shëndetësisë.

²⁶ Shih, Statuti (QRK) nr. 01/2023 i Shërbimit Spitalorë dhe Klinik Universitar të Kosovës <https://shskuk.rks-gov.net/SHSKUK/ShskukStatus>

²⁷ KO 141/24

6.	Qendra e Shëndetit Mendor (QShM) Podujevë	Vizitë përgjithshme	e	20 mars 2025
7.	Klinika Psikiatrike – Reparti i Urgjencës dhe i Kujdesit Intensiv Psikiatrik i Klinikës Psikiatrike (UKIP)	Vizitë ad-hoc		1 prill 2025
8.	Reparti Psikiatrik në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë	Vizitë përgjithshme	e	14 prill 2025
9.	Qendra e Shëndetit Mendor (QShM) Gjakovë	Vizitë përgjithshme	e	14 prill 2025
10.	Shtëpia Integruese në Bashkësi (ShIB) Gjakovë	Vizitë përgjithshme	e	14 prill 2025
11.	Shtëpia me Bazë në Komunitet (ShBK) në Ferizaj – Shtëpi sociale	Vizitë përgjithshme	e	28 prill 2025
12.	Qendra e Shëndetit Mendor (QShM) Ferizaj	Vizitë përgjithshme	e	28 prill 2025
13.	Shtëpia Integruese në Bashkësi (ShIB) Ferizaj	Vizitë përgjithshme	e	28 prill 2025
14.	Reparti Psikiatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë dhe dhomat e dedikuara për të paraburgosurit në Repartin e Kirurgjisë.	Vizitë përgjithshme	e	19 maj 2025
15.	Reparti Psikiatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren dhe dhoma e dedikuar për të paraburgosurit në Repartin e Kirurgjisë.	Vizitë përgjithshme	e	28 maj 2025
16.	Reparti Psikiatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Gjiilan	Vizitë përgjithshme	e	7 korrik 2025
17.	Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshentë	Vizitë ad-hoc		7 tetor 2025
18.	Shtëpia me Bazë në Komunitet (ShBK) në Kamenicë – Shtëpi sociale	Vizitë ad-hoc		17 tetor 2025
19.	Instituti i Psikiatrisë Forenzike (IPFK)	Vizitë përgjithshme	e	31 tetor 2025

Gjatë këtij viti, MKP-ja realizuar 3 vizita ad-hoc: 1 vizitë në repartin UKIP dhe 2 vizita në Klinikën për Fëmijë dhe Adoleshentë, të cilat reparte janë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë.²⁸

²⁸ Klinika e Psikiatrisë është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas Ligjit Nr. 05/L -025 për Shëndetin Mendor, Klinika Psikiatrike ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), e cila, në mungesë të një spitali të përgjithshëm regjional, është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës. Të gjitha repartet (përveç UKIP-it) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe, në raste të caktuara, pa vullnetin e tyre, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) është njësi e mbyllur, ku kryhet trajtimi i pavullnetshëm për rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe të çrregullimeve të personalitetit, të cilat nuk mund të trajtohen në repartet e tjera të hapura. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës, pasi departamentet psikiatrike në kuadër të spitaleve të përgjithshme regjionale nuk disponojnë dhoma të veçanta për trajtimin e rasteve urgjente.

Ndër çështjet që vazhdojnë të jenë shqetësuese edhe gjatë këtij viti mbetet pranimi i personave për trajtim të pavullnetshëm në Repartin UKIP pa vendim gjykate. Gjatë vizitave të realizuara u vërejt se UKIP-i nuk ka evidenca që dëshmojnë se personave të trajtuar pa vullnetin e tyre u ofrohet shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4 të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili përcakton shprehimisht se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj duhet t'i shpjegohen me shkrim brenda 48 orëve arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.

Po ashtu, MKP-ja vërejt se në UKIP dhe në departamentet psikiatrike (në kuadër të spitaleve të përgjithshme regjionale në nivel vendi), në të shumtën e rasteve personave të hospitalizuar me probleme të shëndetit mendor nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit. E njëjta situatë u konstatua edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015²⁹ dhe 2020³⁰, ku theksohet: *“Pranimi i një personi në një institucion psikiatrik mbi baza të pavullnetshme, qoftë në kontekstin e një procesi gjyqësorë civil apo penal, nuk duhet të përfshijë marrjen e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo shmangie nga ky parim duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.”*

Klinika Psikiatrike vazhdon të funksionojë në mungesë të Procedurave Standarde të Operimit dhe pa zhvillimin e Terapisë Okupacionale.

Lidhur me trajtimin e pavullnetshëm, Avokati i Popullit pranoi ankesë³¹ nga L. G., me pretendimin se u mbajt në UKIP në trajtim psikiatrik pa vullnetin e saj, për çka pala u udhëzua për veprimet që duhet t'i ndërmarrë, sepse ankesa nuk bie në mandatin e IAP-së.

Psikiatria për Fëmijë dhe Adoloshentë është i vetmi repart në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë, i nivelit terciar, i cili ka 7 shtretër për hospitalizimin e fëmijëve, si dhe ofron shërbime ambulatorë ditore për moshat nën 18 vjeç. Në kuadër të këtij reparti janë të angazhuar 8 psikiatër për fëmijë, 3 psikologë klinikë, 3 logopedë, 7 infermierë, 1 pedagoge dhe 1 punëtor social.

Gjatë vizitave, Avokati i Popullit vlerësoi se mungesa e qendrave të shëndetit mendor për fëmijë në regjione të Kosovës, numri i ulët i personelit shëndetësor në Psikiatrinë për Fëmijë dhe Adoloshentë në raport me kërkesat, mbingarkesa e stafit, mungesa e mbështetjes me mjete pune dhe trajnime të specializuara për stafin shëndetësor, si dhe kushtet fizike për ofrimin e shërbimeve spitalore, pengojnë ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijë dhe adoloshentë. Për

²⁹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

³⁰ Shih raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

³¹ R 1464/2025

shkak të kësaj gjendjeje, më 10 tetor – Ditën Botërore të Shëndetit Mendor, Avokati i Popullit u prononcua përmes mediave dhe kërkoi vëmendjen e autoriteteve relevante për ndërmarrjen e masave që t'i eliminojnë problemet dhe t'i përmirësojnë kushtet e Klinikës së Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoloshentë³².

Avokati i Popullit, më 6 maj 2025, publikoi Raport me rekomandime lidhur me *Përgjegjësinë e shtetit në raport me shëndetin mendor të fëmijëve*³³.

Departamentet e Psikiatrisë në kuadër të spitaleve të përgjithshme në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan

Qëllimi i vizitave monitoruese në këto departamente ishte mbledhja e informatave, vlerësimi i kushteve, trajtimi i pacientëve, furnizimi me barna, si dhe identifikimi i sfidave të tjera me të cilat ballafaqohet stafi.

Vizitë në Departamentin e Psikiatrisë në Prizren

Departamenti Psikiatrik në Prizren është i ndarë në dy pavijone: një për gjininë femërore me kapacitet prej 10 shtretërish dhe një për gjininë mashkullore me kapacitet prej 10 shtretërish. Po ashtu, funksionon një dhomë e veçantë që përdoret për programin e metadonit, si dhe salla e televizionit, e cila shërben për aktivitete të ndryshme. Departamenti ka edhe dy dhoma të Urgjencës Psikiatrike, të cilat janë jashtë funksionit. Gjatë kohës së vizitës, ekipi u informua se janë të hospitalizuar 12 pacientë.

Trajtimi – Për sa u përket rasteve të hospitalizuara, sipas njoftimit të drejtorit, pacientët e hospitalizuar plotësonjnë një formular të pëlqimit, i cili është formë e përgjithësuar dhe që shfrytëzohet nga të gjitha repartet në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit. MKP-ja konstatoi se, në përgjithësi, në departamentet psikiatrike nuk ekziston formë specifike e pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim të pacientëve psikiatrikë. Ekipi gjithashtu vërejti se karta e të drejtave të pacientit nuk është e vendosur në asnjë hapësirë.

Në Repartin e Psikiatrisë është në dispozicion Terapia Mbajtëse me Metadon (TMM), ku gjatë kohës së vizitës ekipi u informua se janë të përfshirë rreth 15 raste në këtë program.

Sipas pohimeve të drejtorit dhe stafit, nuk patën probleme lidhur me furnizimin me barna, si dhe as me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

Kushtet e akomodimit - u vërejt se nuk janë të mira, për shkak se për vite me radhë nuk u kryen renovime. Banjat për pastrimin e pacientëve nuk janë funksionale. Salla e qëndrimit ditor ka vetëm një televizor dhe asnjë pajisje tjetër. Dhomat e dedikuara për Urgjencë Psikiatrike nuk është funksionale, pasi nuk i plotëson kushtet për izolimin e pacientëve. Dhoma e intervistimit të pacientëve është pa dritare, pa ndriçim artificial dhe e papërshtatshme për trajtimin e rasteve akute psikiatrike. Në përgjithësi, reparti është i demoluar.

Kutia e ankesave për pacientët është jashtë funksionit dhe është nën menaxhimin e Spitalit të Përgjithshëm.

³² <https://oik-rks.org/2025/10/10/avokati-i-popullit-vizitoi-kliniken-psikiatrike-te-femijeve-dhe-adoleshenteve/>

³³ Shih Raportin e plotë <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-6662-2024-pergjegjesia-e-shtetit-ne-raport-me-shendetin-mendor-te-femijeve/>

Stafi shëndetësor - përbëhet nga 10 infermierë, 1 kryeinfermier dhe 5 mjekë psikiatër, ndërsa nuk ka psikolog klinik. Shërbimet sociale ofrohen nga punëtori social i Qendrës së Shëndetit Mendor (QShM), por aktualisht as në QShM Prizren nuk ka punëtor social.

Stafi shëndetësor ndjek trajnime të rregullta në kuadër të edukimit të vazhdueshëm, por sipas pohimeve të tyre, nuk ka trajnime adekuate për specifikat e punës në repart, përkatësisht për menaxhimin e rasteve psikiatrike në përgjithësi.

Në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit të Prizrenit është në dispozicion një dhomë me dy shtretër, e cila funksionon në kuadër të Njesisë Shëndetësore të Qendrës së Paraburgimit në Prizren dhe është e dedikuar vetëm për personat e privuar nga liria. Kjo dhomë u vizitua nga ekipi dhe u vlerësua se i plotëson kushtet për vendosjen e kësaj kategorie.

Vizitë në Departamentin e Psikiatrisë në Pejë

Departamenti Psikiatrik në Pejë ka 7 dhoma aktive me nga dy shtretër secila, një dhomë jashtë funksionit (pasi u dogj nga një pacient para dy vjetësh), një dhomë të ndarë që përdoret për programin e metadonit, sallën e qëndrimit ditor, e cila shërben për aktivitete, dhe një dhomë izolimi për një person. Reparti posedon një hapësirë të jashtme, e cila shfrytëzohet si shëtitore për pacientët e hospitalizuar, por ka nevojë të rregullohet dhe të përshtatet për pacientët psikiatrikë. Gjatë kohës së vizitës, ekipi zhvilloi biseda me 7 pacientë të hospitalizuar, nga të cilët nuk u raportua ndonjë shqetësim.



Trajtimi – Për sa u përket rasteve të hospitalizuara, u vërejt se nuk ekziston formë e shkruar e pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim. Gjithashtu, u konstatua se karta e të drejtave të pacientit nuk është e vendosur në asnjë hapësirë.

Sipas informatave të stafit shëndetësor, disa pacientë qëndrojnë për trajtim sipas urdhrit të Gjykatës, ku qëndrimi në repart mund të zgjasë deri në 3 muaj. MKP-ja analizoi dosjet e pacientëve dhe vërejti se repartit posedon vetëm historitë mjekësore të tyre.

Sipas njoftimit të shefit të repartit, ata ballafaqohen me mungesë të barnave, ku, sipas listës esenciale, rreth 70% e barnave mungojnë. Pacientëve u ofrohen tri shujta ushqimore dhe nuk u raportuan ankesa lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

Kushtet – Ekipi u informua se disa muaj më parë u kryen renovime, ku u gëlqerosën hapësirat dhe u rregulluan muret. U vërejt se nuk ka ujë të ngrohtë për pastrimin e pacientëve, problem që, sipas stafit, vazhdon prej disa muajsh. Dhoma e izolimit, e cila përdoret për rastet agresive dhe për rastet me probleme mendore të paraburgimit (deri në 48 orë), ngjan si një qeli burgu dhe nuk i plotëson kushtet për trajtimin e rasteve me probleme të rënda mendore gjatë krizave, pasi paraqet rrezik për vetëlëndim.

Stafi shëndetësor - përbëhet nga 9 infermierë, 3 mjekë psikiatër dhe 1 pastrues. Punëtori social i QShM Pejës mbulon nevojat edhe për Repartin Psikiatrik, ndërsa nuk ka psikolog klinik. Sipas informatave të siguruara, stafi shëndetësor nuk ka trajnime adekuate për specifikat e punës në repart, për shembull për menaxhimin e rasteve të rënda mendore që janë agresive.

Në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit të Pejës janë në dispozicion dy dhoma me nga dy shtretër secila, të cilat funksionojnë në kuadër të Njësisë Shëndetësore të Qendrës së Paraburgimit në Pejë dhe u dedikohen vetëm personave e privuar nga liria. Ekipi vizitoi këto dhoma dhe kontrolloi librin e evidencave të zyrtarëve korrektues, ku u evidentuan dy raste psikiatrike, të cilat qëndruan mbi tre muaj. Lidhur me këto raste, u informuam se të njëjtët nuk dolën në shëtitje asnjëherë, situatë e cila është e papranueshme dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut.

Gjatë vizitës ishte i pranishëm vetëm një i paraburgosur, i cili u hospitalizua për shkak të problemeve me vesh, i cili nuk pati asnjë ankesë.

Vizitë në Departamentin e Psikiatrisë në Gjakovë

Trajtimi – Edhe në këtë departament psikiatrik nuk ekziston formë e shkruar e pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim, ndërsa rastet e varësisë nga droga, alkooli dhe substanca të tjera plotësojnë formularin e pëlqimit.

Si sfidë, e cila u potencua nga stafi shëndetësor, u evidentua qëndrimi afatgjatë (deri në 1 vit) i disa rasteve, për shkak se u mungon përkujdesja familjare dhe nuk kanë ku të kthehen.

Sipas njoftimit të shefit të repartit, ata ballafaqohen me mungesë të barnave, ku, sipas listës esenciale, rreth 70% e barnave mungojnë, duke detyruar pacientët që vetë t'i blejnë barnat. Pacientëve u ofrohen tri shujta ushqimore. Nuk u raportuan ankesa lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

Kushtet – Sipas informatave të stafit, renovime u kryen para disa vitesh nga Banka Botërore, ku u ndërruan dyert, dritaret dhe kulmi. Tri dhoma të kujdesit intensiv psikiatrik janë jofunksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate. Sipas informatave të shefit të repartit, shpeshherë sillen raste nga policia për trajtim deri në 48 orë, të cilat mbikëqyren gjatë gjithë kohës. Kapaciteti i repartit psikiatrik është 26 shtretër.

Stafi shëndetësor – përbëhet nga 13 infermierë, 5 mjekë psikiatër, nuk ka psikolog klinik, ndërsa punëtori social i QShM Gjakovë i mbulon nevojat edhe për Repartin Psikiatrik.

Vizitë në Departamentin e Psikiatrisë në Gjilan

Trajtimi – Kapaciteti i Repartit Psikiatrik është 15 shtretër, ku janë të pranishëm 9 pacientë të hospitalizuar. Gjatë intervistave me disa prej tyre, nuk u raportua asnjë ankesë lidhur me trajtimin dhe ushqimin. Rastet e hospitalizuara nuk kanë formë të shkruar të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim. Sipas informatave të drejtorit, nga janari deri në ditën e vizitës së MKP-së, rreth 30 raste u trajtuan për 48 orë me urdhër të gjykatës dhe ishin nën mbikëqyrjen e policisë. Që nga muaji qershor i vitit 2012, në Psikiatri zbatohet edhe programi i metadonit. Është e vendosur karta e të drejtave të pacientit, si dhe kutia e ankesave, e cila menaxhohet nga Spitali i Përgjithshëm.

Trajtimi realizohet me barna dhe seanca individuale me psikologun. Për shkak të hapësirave të kufizuara të repartit, nuk mund të zhvillohen aktivitete me pacientët e hospitalizuar. Sipas informatave të stafit, nuk ka probleme lidhur me furnizimin me barna.

Kushtet - Reparti i Psikiatrisë u hap në vitin 2008 dhe kanë qenë të parapara dy kate, mirëpo, për shkak të disa renovimeve të Spitalit të Gjilanit, në hapësirat e dedikuara për aktivitete për rastet psikiatrike, e vendosën Repartin e Neurologjisë. Sipas njoftimit të drejtorit të Repartit të Psikiatrisë, nga shtatori pritet të kufizohen edhe më shumë hapësirat e Psikiatrisë, për shkak të disa renovimeve në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe me këtë mund të rrezikohet edhe konfidencialiteti gjatë trajtimit të rasteve psikiatrike.

Stafi shëndetësor - përbëhet nga 3 psikiatër, 1 psikolog klinik dhe 8 infermierë. Në katin ku ishte vendosur Reparti i Neurologjisë, punojnë 4 neurologë, ku gjatë natës neurologët dhe psikiatrërit kujdestarë kujdesen me radhë për të dy repartet.

Gjetjet e përgjithshme në departamentet psikiatrike në kuadër të spitaleve të përgjithshme në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan

- Në përgjithësi, trajtimi konsiston kryesisht në farmakoterapi dhe nuk ka qasje multidisciplinore. Pra, shumica e institucioneve nuk ofrojnë gjithmonë të gjitha shërbimet e nevojshme për trajtim, të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkohen për ofrimin e shërbimeve bashkëkohore të psikiatrisë spitalore.
- Në departamentet psikiatrike në Prizren, Pejë, Gjakovë, nuk është i punësuar psikologu klinik, përpos në Departamentin e Psikiatrisë në Gjilan.
- Për shkak të mungesës së dhomave për aktivitete dhe kufizimeve të tjera, terapitë okupacionale dhe shërbime të tjera terapeutike nuk mund të ofrohen.
- Departamentet psikiatrike nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve terapeutike të dobishme, të cilat do të mundësonin rikthimin e pacientëve në jetën normale në shoqëri. Shumica e pacientëve kthehen përsëri pas lirimit nga spitali dhe shkalla e risocializimit është shumë e ulët.
- Për sa i përket pëlqimit për trajtim, Avokati i Popullit konstaton se, në përgjithësi, departamentet psikiatrike në katër regjione nuk kanë formë specifike të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim të pacientëve psikiatrikë.

- Në departamentet psikiatrike në Prizren, Gjakovë dhe Pejë nuk e kanë të vendosur Kartën e të drejtave të pacientit dhe Kartën e përgjegjësisë të pacientit, përveç në Gjiilan.
- Sipas deklarimeve të stafit të mesëm, nuk ka trajnime adekuate për menaxhimin e rasteve të vështira për t'u menaxhuar.
- Kutia e ankesave në Prizren është jashtë funksionit.
- Në Departamentin e Psikiatrisë në Pejë, Avokati i Popullit konstaton se dhoma e izolimit ngjan me një qeli burgu dhe nuk i plotëson kushtet për trajtimin e rasteve me probleme të rënda mendore gjatë krizave, pasi paraqet rrezik për vetëlëndim.
- Në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit të Pejës dhe të Prizrenit, dhomat që funksionojnë në kuadër të Njësisë Shëndetësore të burgjeve nuk janë të përshtatshme për qëndrimin afatgjatë të rasteve psikiatrike, pasi nuk kanë mundësi për shëtitje dhe ngjajnë me qeli burgu.
- Në Departamentin e Psikiatrisë në Prizren dhe Gjakovë, dhomat e kujdesit intensiv psikiatrik nuk janë funksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate.
- Infrastruktura në repartet psikiatrike të spitaleve është e vjetruar dhe nuk i përmbush standartet ndërkombëtare.
- Objektet nuk ofrojnë gjithmonë dhoma me një ose dy shtretër, por shpesh dhoma me tre shtretër dhe ndonjëherë edhe me katër shtretër.
- Në departamentet psikiatrike aktualisht nuk kanë kushte për t'u pastruar pacientët e hospitalizuar.
- Shërbimet psikiatrike nuk ofrohen në spitalet rajonale në Mitrovicë dhe Ferizaj, nga këto zona rastet akute me sëmundje mendore referohen në nivelin terciar në Prishtinë.

Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi

Gjatë vitit 2025, ekipi i MKP-së vizitoi 5 Qendra të Shëndetit Mendor (QShM) në Podujevë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan; dhe 4 Shtëpi Integruese në Bashkësi (ShIB) në Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan.

QShM-të e vizituara (përpos asaj në Podujevë) ofrojnë shërbime ditore, trajtim me medikamente dhe aktivitete psiko-sociale. Puna organizohet në dy mënyra: në atë të brendshme, që zhvillohen aktivitete psiko-sociale brenda në Qendër, ku jepet terapi me medikamente falas; dhe në atë që bëhet në terren nga ekipi mobil i Qendrës, ku i mbulojnë regionet e atij qyteti ku ndodhet QShM-ja. Këto vizita të ekipit mobil bëhen me qëllim të mbështetjes psiko-sociale, dhënies së terapisë me rregull, njëkohësisht ofrojnë mbështetje edhe për familjen. QShM-të në staf kanë një psikiatër, psikolog dhe disa infermierë.

Gjatë vizitave në QShM, përpos trajtimit, kushteve, ekipi i MKP-së i kushtoi rëndësi edhe ekzekutimit të Masës së Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri, të cilën masë gjykatat e caktojnë kryesisht në QShM. Gjatë vizitave, u vlerësua se në QShM Gjakovë, Podujevë, Ferizaj, të gjitha rastet që janë me Masë të Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri dhe që marrin shërbime të rregullta, evidentohen në protokoll të veçantë, ndërsa në QShM Prishtinë, Prizren dhe Gjiilan nuk e praktikojnë një gjë të tillë.

Për sa i përket furnizimit me barna, ushqim për qëndrim ditor të pacientëve nuk u raportuan ankesa nga stafi dhe pacientët e QShM-ve të vizituara.

Në QShM në Ferizaj, si sfidë u evidentua se vetura e vjetruar po paraqet problem në ofrimin e shërbimeve në terren, pasi mbulojnë komunat, si: Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpcë dhe Shtime, kurse rastet nga Vitia nuk janë në regjionin e Ferizajt, mirëpo marrin shërbime nga QShM Ferizaj.

Në kuadër të QShM-së Prishtinë është edhe Qendra e Shëndetit Mendor në Podujevë, për të cilën Avokati i Popullit përpiloi Raport me rekomandime³⁴. Qëllimi i vizitës në QShM Podujevë ishte të vlerësohet dhe të analizohet ofrimi i shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet, si dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor.

Sipas protokollit të regjistrimit të rasteve në QShM Podujevë, rreth 500 dosje janë të evidentuara, 390 prej tyre janë raste aktive, që kanë nevojë për shërbime të shëndetit mendor, rreth 55 raste janë me vendim të gjykatës, që e kanë Masën e Trajtimin të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri. Avokati i Popullit përmes raportit me rekomandime konstatoi si në vijim:

QShM-ja në Podujevë nuk ka kushte minimale për ofrimin e shërbimeve për personat me probleme të shëndetit mendor; kushtet nuk janë të përshtatshme as për personelin, as për personat që merrnin këshillime apo medikamente.

Për shkak të kushteve të papërshtatshme, qëndrimi ditor dhe trajtimi psiko-social nuk realizohen, si dhe rrezikohet konfidencialiteti i shërbimeve. Stafi ishte munduar ta organizonte punën në terren për të mundësuar trajtimin psikiatrik të rregullt dhe për t'i furnizuar pacientët me barna.

Nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e ShSKUK-së dhe as nga Komuna e Podujevës bazuar në marrëveshjen për zhvendosjen e QShM-së në një objekt të përshtatshëm. Po ashtu, QShM-ja në Prishtinë, e cila menaxhon edhe Qendrën në Podujevë, nuk ndërmori veprime lidhur me këtë çështje.

QShM-ja në Podujevë është e furnizuar mjaftueshëm me barna dhe me mjete higjienike.

Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB) – ofrojnë kujdes shëndetësor 24 orë në funksion të rehabilitimit dhe riintegrit social të klientëve me çrregullime kronike psikotike në remision³⁵. Në ShIB nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, as me demencë të të gjitha llojeve, as me sëmundje të vartësisë dhe as rastet sociale. Vendosja e rezidentëve në këto shtëpi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës, i cili u shfuqizua me Vendim të QRK-së, Nr. 02/50, të datës 23.12.2021.

Në ShIB-të e Gjakovës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit - bazuar në dosjet e rezidentëve, të gjitha rastet ishin me diagnoza kronike psikiatrike. Ekipi vërejti se në asnjërën nga këto shtëpi nuk ka mbipopullim.

Trajtimi – Gjatë vizitës u vërejt një qasje e afërt e personelit ndaj rezidentëve, ku kryesisht shfaqej një klimë pozitive brenda shtëpive të vizituara. Rezidentët dukeshin mirë nga veshja

³⁴ Shih raportin për QShM Podujevë, i publikuar më 5 gusht 2025, <https://oik-rks.org/2025/08/05/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-shendetit-mendor-ne-podujeve/>

³⁵ Remisioni është term mjekësor që përdoret për të përshkruar një periudhë, gjatë së cilës simptomat e një sëmundjeje zvoglohen apo zhduken plotësisht. Gjendja në remision për rastet me sëmundje mendore nënkupton një përmirësim të ndjeshëm ose mungesë të dukshme të simptomave.

dhe higjiena. Nuk u vërejtën shenja të lëndimeve trupore te rezidentët. Ekipi monitorues i intervistoi rezidentët dhe nuk raportuan ankesa për ndonjë formë të keqtrajtimit.

Në përgjithësi, realizohen aktivitete të ndryshme, si loja me pingpong, dëgjimi i muzikës, si dhe angazhimi në punë shtëpiake, përfshirë pastrimin, kuzhinën dhe mirëmbajtjen e oborrit, për aq sa rezidentët mundën.

Standardet e KPT-së theksojnë se trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient. Ai duhet ta përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë qasje në terapi okupacionale, terapi në grup, psikoterapi individuale, art, teatër, muzikë dhe sporte³⁶. Gjatë vizitës, u vërejt se në ShIB të vizituara nuk kanë Plan Individual të Trajtimit, përpos disa aktiviteteve, siç u cekën më lart.

Kushtet e akomodimit në Shtëpitë e vizituara janë përgjithësisht të mira, përveç në ShIB Gjilan, ku banjat janë shumë të dëmtuara dhe të papastra, ndërsa dhomat janë të mira dhe kanë ndriçim.

Për sa i përket furnizimit me barna, ushqim, veshmbathje, nuk ka probleme dhe nuk raportuan ankesa për trajtim dhe ushqim.

Gjatë vizitave, ekipi vërtetoi se të gjitha ShIB-të e vizituara posedojnë vetëm një fletore ditore, ku evidentohen të gjitha aktivitetet me rezidentët, si: ndërrimi i stafit, gjendja e pacientëve, incidentet dhe shqetësimet e rezidentëve. Nuk ka protokolle të veçanta për evidentimin e incidenteve apo lëndimeve trupore. Bazuar në fletoren ditore të ShIB-të e vizituara, nuk u evidentua asnjë incident.

Klientëve të vendosur në ShIB, në përgjithësi, u kryhen analizat laboratorike një herë në vit. Vlen të theksohet se klientët që kanë edhe sëmundje të tjera, përveç çrregullimeve mendore, u nënshtrohen analizave laboratorike sa herë që është e nevojshme.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike

Ekipi monitorues realizoi vizitë të përgjithshme në Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK) me qëllim të vlerësimit të respektimit të të drejtave themelore të personave që kryen vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose me aftësi esenciale të zvogëluar mendore dhe që janë subjekt i urdhrat të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; të personave që janë subjekt i urdhrat të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor; dhe të të burgosurve që zhvilluan çrregullim mendor gjatë burgimit dhe u vendosën në njërin nga repartet e IPFK-së. Të drejtat e këtyre personave garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

³⁶ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12].



Konstatimet e Avokatit të Popullit për IPFK-në

- Avokati i Popullit konstaton se ende nuk është zgjidhur çështja e statutit ligjor të IPFK-së, edhe pse ndër vite Avokati i Popullit e ngriti këtë çështje dhe e ripërsëriti rekomandimin e njëjtë.
- Në Repartin B të IPFK-së nuk ekziston protokoll specifik ku evidentohen vetëm mjetet e kufizimit, ashtu siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, paragrafët 2 dhe 3, standardeve të KPT-së, si dhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të IPFK-së.
- Stafi shëndetësor dhe ai i sigurimit morën vetëm në fillim një trajnim bazik kapje/kontrolle për menaxhimin e rasteve të vështira dhe asnjëherë tjetër nuk u realizuan trajnime të tilla për stafin.
- Kamerate e sigurisë nuk janë funksionale.
- Stafi i sigurimit ndërrohet shpesh nga kompanitë private, gjë që paraqet vështirësi pasi ata rrinë brenda në reparte dhe shpesh ndihmojnë stafin shëndetësor në menaxhimin e rasteve.
- Ka mungesë të materialeve didaktike, si letra, ngjyra për vizatime dhe mjete të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale.
- Lidhur me kushtet e jetesës, Avokati i Popullit konstaton se filluan punimet për rritjen e kapaciteteve të IPFK-së.
- Aplikimi i vikendeve terapeutike (që ka munguar ndër vite) nuk është përfshirë në Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së. Aplikimi i vikendeve terapeutike, i cili munguar ndër vite, nuk u përfshi në PSV-në e IPFK-së.

- Lidhur me rishikimin e vendimeve nga gjykatat kompetente, pati ndryshime pozitive, duke u evidentuar një bashkëpunim më i mirë i gjykatave me IPFK-në dhe pjesëmarrja e pacientëve forenzikë në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideron të nevojshme.
- Për sa i përket së drejtës për trajtim, u konstatua ndër vite, si nga Avokati i Popullit, ashtu edhe nga KPT-ja, se në të shumtën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim, as e drejta për refuzim të trajtimit, gjendje e cila vazhdon të jetë e njëjtë.
- Në Psikiatrinë Forenzike ekzistojnë kutitë e ankesave për pacientë, të cilat janë të etiketuara siç duhet, mirëpo pacientët nuk ishin në dijeni për procedurën me shkrim të ankimit.
- Avokati i Popullit vendosi kutitë e ankesave, por ato nuk ishin funksionale, për shkak të dëmtimit ose ndryshkut dhe nuk hapeshin. Kutitë e reja do të vendosen pas përfundimit të renovimeve në IPFK.

Në bazë të të gjeturave gjatë vizitave dhe konstatimeve, Avokati të Popullit do të publikojë Raport me rekomandime për IPFK-së gjatë tremujorit të parë të vitit 2026.

Në bazë të të gjeturave gjatë vizitave dhe konstatimeve, Avokati i Popullit do të publikojë Raport me rekomandime për IPFK-në gjatë tremujorit të parë të vitit 2026.

INSTITUCIONET E KUJDESIT SOCIAL

Shtëpitë me Bazë në Komunitet

Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK) – funksionojnë në bazë të Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku në nenin 20 theksohen shërbimet dhe format e mbrojtjes, duke përfshirë edhe shtëpitë e komunitetit dhe strehimin rezidencial.

ShBK-të rregullohen me nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehim Rezidencial³⁷. Neni 19, paragrafi 2, i këtij Udhëzimi përcakton: “Në Shtëpinë me Bazë në Komunitet për persona të rritur dhe të moshuar me paafësi intelektuale numri maksimal i personave të vendosur është dymbëdhjetë (12) banorë.” Lidhur me Procedurat për pranim në strehim rezidencial, neni 20, paragrafi 5, thekson: “Qendra për Punë Sociale merr vendim për strehimin e përfituesit në Shtëpinë me Bazë në Komunitet pas marrjes së pëlqimit nga Paneli për Strehim Rezidencial në nivel qendror, respektivisht në nivel lokal.” Për strehim në të gjitha format e strehimit rezidencial vendos Qendra për Punë Sociale, në territorin e së cilës personi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Komunat që kanë ShBK janë Kamenica, Deçani, Ferizaj, Vushtrria, Lipjani, Graçanica, Shtimja dhe Prizreni. Aktualisht, këto shtëpi kanë kapacitet për 10 rezidentë secila, përveç ShBK-së në Shtime, e cila ka kapacitet 12 shtretër.

Gjatë vitit 2025, u vizituan ShBK-të në Kamenicë, Ferizaj dhe Prizren, ku u konstatua se në këto shtëpi nuk ka mbipopullim.

³⁷ Udhëzim Administrativ MD-Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, i nënshkruar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë me datë: 13.02.2025 me Vendim Nr. 51/2025, të datës 13.02.2025. Shih UA të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=101206>.

Trajtimi i rezidentëve në ShBK-të e Ferizajt, Prizrenit dhe Kamenicës – MKP-ja intervistoi rezidentët pa praninë e stafit të këtyre shtëpive dhe nuk mori ankese për trajtimin e tyre. Për sa u përket incidenteve, gjatë vizitave nuk u evidentua asnjë incident në fletoren e raportit ditor të stafit të këtyre shtëpive. Sipas informatave të stafit, ndonjëherë pati fjalosje mes rezidentëve, por rastet e tilla u menaxhuan mirë.

Kushtet në ShBK-të e vizituara – Në ShBK Ferizaj, kushtet nuk janë të mira. Kuzhina është në gjendje jo të mirë, ndërsa dollapët janë të dëmtuar. Në depon ku mbahet ushqimi, tavani pikon ujë, ka lagështi dhe myk, gjë që paraqet rrezik për rënien e tavanit. Në dhoma, dritaret nuk mbyllen mirë dhe nuk k roleta, ndërsa rezidentët kanë në dispozicion vetëm një banjë, e cila nuk është shumë e përshtatshme dhe nuk ka mbajtëse për personat me vështirësi në ecje ose të moshuarit. Gjatë natës kujdestaron vetëm një infermier, ndërsa nuk ka sigurim fizik. Stafi qëndron në të njëjtën dhomë me rezidentët, pa ndonjë hapësirë të ndarë.

Në ShBK Prizren u vërejt dhe u konfirmua nga stafi se disa vite nuk ka pasur renovime. Sanitaria është e dëmtuar, ndërsa dyert nuk mbyllen mirë dhe disa prej tyre janë të prishura.

Në ShBK Kamenicë, në përgjithësi ka kushte shumë të mira, secili rezident ka shtratin, dollapin personal, veshmbathje të mjaftueshme. Për sa u përket kushteve materiale dhe infrastrukturës, gjatë këtij viti filluan me renovime, si: rregullimi i banjave, lavanderisë, tualeteve dhe rregullimin e ambientit të jashtëm.

Në ShBK Kamenicë, ekipi monitorues analizoi dosjet e rezidentëve dhe disa regjistra/fletore, duke përfshirë regjistrin e vizitave mjekësore, fletoret e aktiviteteve, të vizitave, të terapisë së rregullt, të kujdestarisë dhe të shqetësimeve apo incidenteve. Ekipi nuk vërejti asnjë incident në regjistrin e incidenteve. Sipas dosjeve shëndetësore, të gjithë rezidentët janë me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillim mendor dhe pa zotësi të veprimt. Çdo vit u vazhdohet kontrata e qëndrimit në shtëpi, ndërsa disa rezidentë kanë edhe vizita familjare.

MKP-ja vërejti se ShBK-të e tjera nuk mbajnë regjistra të veçantë si në Kamenicë. Prandaj, inkurajon udhëheqësit e këtyre ShBK-ve të marrin shembull nga ShBK Kamenicë, dhe thekson se të gjitha këto shtëpi duhet të jenë të unifikuara dhe të funksionojnë në përputhje me Udhëzimin Administrativ MD Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, ku në nenin 25 parashihet hartimi i planit individual të kujdesit.

Mjetet e kufizimit në ShBK-të e vizituara – në ShBK-të nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik.

Shërbimet shëndetësore të ShBK-ve të vizituara - realizohen në qendrat e mjekësisë familjare të komunave përkatëse, ndërsa shërbimet psikiatrike i realizojnë në Qendrat e Shëndetit Mendor.

Furnizimet - për sa u përket furnizimeve me veshmbathje, ushqim, barna si dhe ngrohje, ekipi nuk vërejti mangësi në shtëpitë e vizituara.

Gjetjet e përgjithshme për ShBK-të e vizituara

Gjatë vizitave në këto Shtëpi, ekipi i MKP-së konstaton:

- Shtëpitë e vizituara nuk kanë Plan Individual të Kujdesit për rezidentët, ashtu siç parashihet në nenin 25 të Udhëzimit Administrativ MD Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial.

- Në ShBK Ferizaj, kushtet në përgjithësi nuk janë të mira, kuzhina dhe dritaret janë të dëmtuara, ndërsa depoja ku mbahet ushqimi ka lagështi dhe myk.
- MKP-ja konstaton se ShBK-të e tjera nuk mbajnë regjistra të veçantë, siç janë regjistrat e incidenteve/shqetësimeve, të terapisë, aktiviteteve dhe vizitave mjekësore, si në ShBK Kamenicë. Për këtë, ekipi monitorues inkurajon udhëheqësit e ShBK-ve të tjera të marrin shembull nga ShBK Kamenicë.
- MKP-ja vërejti se ShBK-të kanë kodin buxhetor të veçantë në komunat e tyre, por për shkak të borxheve të mëdha të komunave përkatëse, përmbaruesit konfiskuan mjetet, gjë që krijoi probleme me planifikimin për këtë kategori rezidentësh.

V. Aktivitetet dhe takimet e MKP-së me institucionet kompetente gjatë vitit 2025

MKP-ja, gjatë këtij viti, zhvilloi aktivitete dhe takime të rregullta me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmbushjen e objektivave strategjike. Këto aktivitete shërbyen për shkëmbimin e përvojave, adresimin e çështjeve me rëndësi, si dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e rekomandimeve.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet relevante, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së, më 15 janar 2025, realizuan takim me drejtorin e Departamentit për Kufi për të diskutuar lidhur me raportin me rekomandime të IAP-së për pikat kufitare.

Më 30 janar 2025, Avokati i Popullit dhe drejtoresha e MKP-së realizuan takim me ekspertin e Ombudsmanit të Greqisë, z. Yiannis Boutselis – Senior Investigator, i cili kërkoi monitorimin e shtetasve të huaj nga Kosova në vendin e tij.

Më 30 janar 2025, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Këshilli i Evropës, me temë *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*, duke diskutuar për PSV-të e IPFK-së.

Më 7 shkurt 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me përfaqësues të OSBE-së, me qëllim diskutimin e aktiviteteve të përbashkëta, të cilat planifikohen të mbahen gjatë këtij viti, si trajnimet.

Më 13 shkurt 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve.

Më 24 shkurt 2025, drejtoresha e MKP-së realizoi takim në ShKK, ku të pranishëm ishin ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, drejtorët e qendrave korrektuese dhe të paraburgimit, si dhe përfaqësues nga EULEX-i.



Më datat 25-27 shkurt 2025, anëtarët e MKP-së morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Programi për të Drejtat Civile Kosovë (CRP/K), së bashku me organizatat partnere të përfshira në rrjetin joformal Këshilli Ballkanik për Refugjatë dhe Migracion (BRMC) dhe Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) në Ballkanin Perëndimor, në kuadër të projektit *“Përfshirja e të*

huajve në Ballkanin Perëndimor – Qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike”, i quajtur “FOSTER”, mbështetur nga Unioni Evropian, trajnim për qasjen në të drejtat bazë ekonomike dhe sociale për kategoritë e cënueshme të të huajve.

Më 27 shkurt 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me ushtruesin e detyrës së drejtorit të QKUK-së dhe anëtarin e Komisionit të Ankesave.

Më 3 mars 2025, drejtoresha e MKP-së realizoi takim me përfaqësuesin e Njesisë Korrektuese të Misionit EULEX, me qëllim të diskutimit të punës dhe harmonizimit të aktiviteteve me EULEX-in.

Më 14 mars 2025, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së realizuan takim me përfaqësues të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), lidhur me tryezën që do të organizohet më 8 prill dhe konferencën më 26 qershor, si dhe për disa raste individuale.

Më datat 19-21 mars 2025, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Këshilli i Evropës, me temë *“Përmirësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria”* - diskutim për rishikimin e protokolleve të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB), Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) dhe Udhëzuesit për trajtimin e personave me çrregullime mendore.

Më 26 mars 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me gjyqtarë nga Paneli për Lirim me Kusht.

Më datat 1-3 prill 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me mbështetjen e OSBE-së, me temë: *“Hartimi i manualit (broshurës) për të drejtat dhe detyrimet e personave të burgosur”*.

Më 1 prill 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), në lidhje me bashkëpunimin mes MKP-IAP-së dhe IPK-së.

Më 7 prill 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Njësia Korrektuese e EULEX-it, me temë: *“Forcimi i bashkëpunimit në zinxhirin e drejtësisë për të rritur shqiptimin e dënimeve alternative, masave të diversitetit dhe për ti ngritur kapacitetet e institucioneve të Kosovës për ta adresuar rehabilitimin dhe ri integrimin e kryesve të veprave penale.”*



Më 8 prill 2025, me organizim të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), u mbajt tryezë me temë: *“Diskutim lidhur me zbatimin e Rekomandimeve të CPT”*, ku morën pjesë Zyra për

Qeverisje të Mirë, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, Këshilli Prokurorial, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Qendra e Mbajtjes për të Huaj, Instituti Special i Shtimes (ISSh), shoqëria civile dhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës, EULEX dhe UNMIK.

Më 17-18 prill 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga EULEX-i, me temë: *“Forcimi i bashkëpunimit në zinxhirin e drejtësisë për të rritur shqiptimin e dënimeve alternative, masave të diversitetit dhe për t’i ngritur kapacitetet e institucioneve të Kosovës për ta adresuar rehabilitimin dhe riintegrimin e kryesve të veprave penale”*.

Më 18 prill 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga ShKK-ja, lidhur me propozimet e dhëna për pasurimin e Kantinës në Qendrat e Paraburgimit dhe Korrektuese, si pjesë e grupit punues në ndërtimin e Manualit për të Drejtat dhe Detyrimet e të Burgosurve.

Më 29 prill 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Njësia Korrektuese e EULEX-it, me temë: *“Forcimi i bashkëpunimit në zinxhirin e drejtësisë për të rritur shqiptimin e dënimeve alternative, masave të diversitetit dhe për t’i ngritur kapacitetet e institucioneve të Kosovës për ta adresuar rehabilitimin dhe riintegrimin e kryerësve të veprave penale”*.

Më 30 prill 2025, anëtarët e MKP-së, morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), me temë: *“Identifikimi i hershem i viktimave potenciale dhe viktimave të trafikimit në mesin e migracionit të përzier (imigrantëve, azilkërkuesve dhe personave me mbrojtje ndërkombëtare) në Kosovë”*.

Më 6 maj 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në takimin IV të Këshillit Drejtues të projektit *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*.

Më 6 maj 2025, me organizimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) dhe Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan (QKML), u realizua aktiviteti ndërinstitutional, ku Avokati i Popullit priti në takim të miturit nga Qendra Korrektuese-Edukuese në Lipjan, si pjesë e aktiviteteve të kësaj qendre. Avokati i Popullit bashkëbisedoi me të miturit në lidhje me punën, aktivitetet, si dhe i njoftoi për mandatin dhe kompetencat e tij.

Më 8 maj 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në tryezën e organizuar nga Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), me temë: *“Trajtimi fillestar i azilkërkuesve dhe migrantëve të parregullt si dhe bashkëpunimi ndërinstitutional”*.

Më 8 maj 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me Shefin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut e UNMIK-ut dhe Përfaqësues i Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i informatave dhe diskutimi mbi situatën aktuale të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në parandalimin e torturës.

Më 15 maj 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me gjyqtarët e rinj që përfundojnë trajnimin në Akademinë e Drejtësisë, ku u prezantua roli i MKP-së në kuadër të IAP-së.

Më 16 maj 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Njësia Korrektuese e EULEX-it, me temë: *“Forcimi i bashkëpunimit në zinxhirin e drejtësisë për të rritur shqiptimin e dënimeve alternative, masave të diversitetit dhe për t’i ngritur kapacitetet e*

institucioneve të Kosovës për ta adresuar rehabilitimin dhe ri integrimin e kryesve të veprave penale”. Me këtë rast u prezantua Manuali i Shërbimit Sprovues të Kosovës, si dhe u përmbledhën të gjeturat dhe rekomandimet përfundimtare.

Më 5 qershor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në aktivitetin artistik dhe rehabilitues të organizuar nga Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, në bashkëpunim me organizatën Monumenta.



Më 26 qershor 2025 u mbajt konferenca ndërkombëtare e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), me temë: *“Shëndeti Mendor në Institucionet e Privimit të Lirisë: Roli i MKP-ve në mbrojtjen e të drejtave si dhe sigurimin e mbikëqyrjes efektive”*.



Më 27 qershor 2025 e vizituam Pavijonin D në Qendrën Korrektuese në Dubravë së bashku me delegacionin e Konferencës së 26 qershorit 2025.



Më 3 korrik 2025, anëtarët e MKP-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.



Më 7 korrik 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.

Më 15 korrik 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me drejtorin e DShAM-së, lidhur me Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, në Vranidoll.

Më 17 korrik 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në tryezën e organizuar nga Avokati i Popullit, me temë: *“Sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nga mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna”*.

Më 18 korrik 2025, këshilltarja e Avokatit të Popullit, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me gjyqtarë nga Paneli për Lirim me Kusht.

Më 29 korrik 2025, Avokati i Popullit, zëvendësi i Avokatit të Popullit, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në tryezën e organizuar nga Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), me temë: *“Gjetjet dhe rekomandimet nga aktivitetet e përbashkëta monitoruese të CRP/K-së, UNHCR-së dhe MKP-së gjatë periudhës 2024 – 2025”*.



Më 30 korrik 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në trajnimin me Policinë e Kosovës, organizuar nga Kolegji Universum, ku mbajti ligjëratë me temën: *“Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Policia e Kosovës”*.

Më 31 korrik 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga ShKK-ja, me temë: *“Siguria në institucionet korrektuese, zbatimi i programeve rehabilituese, si dhe punët e realizuara në përmirësimin e infrastrukturës me angazhimin e të dënuarve”*.

Më datat 18 – 20 gusht 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në trajnimin e organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, projekti: *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*, me temë: *“Dokumentimi i Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues në burgje dhe institucionet e tjera të mbyllura, në përputhje me Protokollin e Stambollit”*.

Më 19 gusht 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.



Në vazhden e takimeve të rregullta që MKP-ja realizon me EULEX-in, më 10 shtator 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me përfaqësuesin e Njësisë Korrektuese të Misionit EULEX, me qëllim diskutimin e punës dhe harmonizimin e aktiviteteve me EULEX-in.

Më 11 shtator 2025, anëtarët e MKP-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezentimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.



Më 16 shtator 2025, këshilltarja e Avokatit të Popullit dhe drejtoresha e MKP-së realizuan takim me përfaqësuesin e UNMIK-ut, me qëllim diskutimin e aktiviteteve të MKP-së.

Më 18 shtator 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me përfaqësues nga MPB-ja në Drejtorinë për Migracion, në kuadër të Policisë së Kosovës.

Më 19 shtator 2025, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.

Më datat 24 deri më 26 shtator 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së, si dhe këshilltarë nga departamentet e IAP-së, morën pjesë në trajnimin e organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Intervistimi i personave me probleme të shëndetit mendor”*.

Më 25 shtator 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, projekti: *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*, me temë: *“Trajnimi i tretë kaskadë mbi Dokumentimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues në burgje dhe institucionet e tjera të mbyllura, në përputhje me Protokollin e Stambollit”*.



Më 29 shtator 2025, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.

Më 30 shtator 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me institucionet e nivelit qendror përgjegjëse për procesin e riintegritimit dhe integritimit.

Më 30 shtator 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe drejtoresha e MKP-së realizuan takim me përfaqësues nga Misioni Vlerësues për Mbikëqyrjen e Policisë (TAIEX).



Më 1 tetor 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga IAP-ja, me temë: *“Prezantimi i 25 Vjet të Institucionit të Avokatit të Popullit: Një Udhëtim i Përbashkët”*, në të cilin morën pjesë pesë organizata ndërkombëtare dhe shumica e ambasadave të huaja në Kosovë.

Më 1 tetor 2025, drejtoresha e MKP-së realizoi takim me anëtarët e MKP-së lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit.

Më 2 tetor 2025, anëtarët e MKP-së realizuan takim me drejtorin e Klinikës Psikiatrike, ku u diskutua lidhur me organizimin e 10 Tetorit - Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.

Më 3 tetor 2025, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga OSBE-ja, me temë: *“Prezantimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë – Mandati i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës”*.

Më 6 tetor 2025, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së realizuan takim me përfaqësues nga Instituti i Psikiatriisë Forenzike, lidhur me bashkëpunimin dhe planifikimin e vizitave në të ardhmen.

Më 7 tetor 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me ushtruesen e detyrës së drejtorit të Klinikës së Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshentë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin e aktivitetit për 10 tetorin - Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.

Më 9 tetor 2025, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së realizuan takim me drejtorin e Klinikës Psikiatrike, lidhur me shënimin e 10 Tetorit – Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.

Më 10 tetor 2025, Avokati i Popullit, zëvendësi i Avokatit të Popullit, drejtoresha dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga IAP-ja dhe Klinika Psikiatrike me rastin e shënimit të 10 Tetorit – Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.



Më 13 tetor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me drejtorin e OSBE-së, i cili u njoftua për bashkëpunimin IAP – OSBE, konkretisht për trajnimet e organizuara së bashku me IPK-në.

Më 27 tetor 2025, drejtoresha e MKP-së realizoi intervistë për Info in Lajmi, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me migrimin.

Nga data 28 deri më 30 tetor 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Këshilli i Evropës së bashku me Policinë e Kosovës, lidhur me parandalimin e vetëvrastjes në qendrat e ndalimit dhe paraburgimit.

Më 12 nëntor 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar nga Humanus Vita, me temë: *“Përtej uniformës, dinjitet për gratë migrante”*.



Më data 11 – 14 nëntor 2025, Avokati i Popullit, drejtoresha e MKP-së dhe drejtori i Zyrës për Çështje Ligjore realizuan vizitë zyrtare në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, ku monitoruan seancat gjyqësore që u mbajtën më 12 e 13 nëntor 2025. Gjatë kësaj vizite, Avokati i Popullit u takua me Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Hagë dhe me përfaqësues të tjerë të ambasadës, si dhe u takua me përfaqësues të Zyrës së Regjistrimit të DhSK-së, në kuadër të së cilës funksionon Zyra për Mbrojtje të Viktimave.

Më 18 nëntor 2025, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së realizuan takim me përfaqësuesin e Njësisë Korrektuese të Misionit EULEX, me qëllim diskutimin e punës dhe harmonizimin e aktiviteteve me EULEX-in.

Më 19 nëntor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në publikimin e Raportit të Monitorimit të Sistemit të Drejtësisë, në lidhje me rastet e monitoruara të personave të privuar nga liria.

Më 20 nëntor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në konferencën e organizuar nga QKRMT-ja, me temën: *“Mbështetja e riintegritimit socio-ekonomik dhe sigurimi i të drejtave të barabarta të pjesëmarrjes për gratë dhe vajzat e riatdhesuara dhe refugjate në Kosovë”*.

Më 20 nëntor 2025, dy anëtarët e MKP-së morën pjesë në aktivitetin kulturor-artistik të organizuar nga Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan.

Më 21 nëntor 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me rastin e ceremonisë solemne të shënimit të 26-vjetorit të themelimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



Më 24 dhe 25 nëntor 2025, anëtarët e MKP-së morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Këshilli i Evropës, me temë: *“Praktikat Standarde të Veprimit (PSV) të Departamentit Shëndetësor në Burgje (DShB) për Policinë dhe aktorët e tjerë relevantë”*.

Më 27 nëntor 2025, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në kuadër të Fushatës Globale të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, me temë: *“Gratë në Uniformë – Forcimi i Mbrojtjes dhe Sigurisë për të Gjithë”*.

Më 27 nëntor 2025, anëtari i MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Save the Children, me qëllim ngritjen e kapaciteteve në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Më 6 dhjetor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga QKRMT-ja, në kuadër të Fushatës Globale të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, me temë: *“Ecim bashkë, mbështesim bashkë, trauma nuk ka afat”*.

Më 17 dhjetor 2025, drejtoresha dhe anëtarët e MKP-së realizuan takim me përfaqësuesin e Organizatës Joqeveritare ACDC, Dushan Radojkoviç, lidhur me angazhimin e mjekut në MKP.

Më 18 dhjetor 2025, drejtoresha e MKP-së realizoi takim me Katrine Antonsen, kërkuese doktrature në Departamentin e Kriminologjisë dhe Sociologjisë së Ligjit në Universitetin e Oslos, Norvegji. Katrine Antonsen ishte drejtuesja e projektit kërkimor *“Promovimi i Drejtësisë në një Kohë Trazirash: Eksportet Penale Skandinave dhe Promovimi i Sundimit të Ligjit (JustExports)”*, financuar nga Këshilli Norvegjez i Kërkimeve.

Më 30 dhjetor 2025, Avokati i Popullit, zëvendësja e tij, drejtoresha e MKP-së dhe drejtori i DÇLH-së realizuan takim përmes platformës “Zoom” për të diskutuar lidhur me të gjeturat e vizitës në Dhomat e Specializuara në Hagë dhe u pajtuan për hartimin e shkresave për Gjykatën Speciale, Komitetin Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC).

Bashkëpunimi ndërkombëtar i MKP-së gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, MKP-ja, përmes realizimit të një sërë takimesh dhe vizitash zyrtare, arriti ta forconte bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira profesionale.

Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, më 14 janar 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim online me Rrjetin Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI). Tema e diskutimit ishte monitorimi i MKP-së në qendrat e azilit dhe migracionit, si dhe ngritja e kapaciteteve monitoruese.

Më 5 dhe 6 shkurt 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe drejtoresha e MKP-së morën pjesë në Forumin e organizuar nga projekti i përbashkët BE/KE “Mbështetje Këshillit të Evropës për Rrjetin e BE-së të institucioneve monitoruese të burgjeve”.



Më 9-10 prill 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Forumi Evropian i Mekanizmave Kombëtar për Parandalim të Torturës, me temë: “Monitorimi i MKP-ve në kontekst të migracionit”.



Më 5-6 qershor 2025, anëtarët e MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Forumin Evropian i Mekanizmave Kombëtar për Parandalim të Torturës, me temë: *“Monitorimi i Qendrave të Ndalimit në Stacionet Policore”*.



Më datat 20 – 23 tetor 2025, anëtarja e MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga IOM-i, me temë: *“Alternativat e Mbajtjes së Imigrantëve”*.

Më datat 4 – 6 nëntor 2025, drejtoresha dhe anëtari i MKP-së morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Rrjeti i MKP-ve i Evropës Juglindore (NETWORK NPM), me temë: *“Hospitalizimi i pavullnetshëm në procedurat paragjyqësore dhe civile”*.



Më 13 nëntor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe anëtarja e MKP-së morën pjesë në takimin online të organizuar nga ENNHRI. Tema e diskutimit ishte paraqitja e përditësimeve

nga anëtarët lidhur me punën e tyre të fundit në fushën e azilit dhe migracionit, si dhe zhvillimet lidhur me zbatimin e Paktit të BE-së për Migracionin dhe Azilin.

Më 24 dhe 25 nëntor 2025, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në konferencën e organizuar nga Frontex, me temë: *“Monitorimi i Pavarur sipas Paktit të ri për Migracionin – Inventarizim dhe planifikim paraprak”*.



Vizitat e realizuar gjatë vitit 2025

Nr.	Institucioni i inspektuar	Lloji i vizitës	Data
1	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë përcjellëse	23.1.2025
2	Shtëpia Integruese në Bashkësi, Gjilan	Vizitë e përgjithshme	24.1.2025
3	Qendra e Shëndetit Mendor, Gjilan	Vizitë ad-hoc	24.1.2025
4	Qendra Korrektuese për Femra, Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
5	Qendra Korrektuese për të Mitur, Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
6	Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur, Lipjan	Vizitë ad-hoc	27.1.2025
7	Qendra e Shëndetit Mendor, Prizren	Vizitë e përgjithshme	27.1.2025
8	Shtëpia Integruese në Bashkësi, Prizren	Vizitë e përgjithshme	27.1.2025
9	Shtëpia me Bazë në Komunitet, Prizren	Vizitë përcjellëse	28.1.2025
10	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	29.1.2025
11	Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	Vizitë përgjithshme	31.1.2025
12	Qendra e Përkohshme e Pritjes në Vranidoll	Vizitë e përgjithshme e përbashkët me CRPK-në	18.2.2025
13	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë përcjellëse	20.2.2025
14	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	27.2.2025
15	Stacioni Policor Mitrovicë - Veriu	Vizitë ad-hoc	13.3.2025
16	Stacioni Policor Zveçan	Vizitë ad-hoc	13.3.2025
17	Stacioni Policor Leposaviq	Vizitë ad-hoc	13.3.2025
18	Stacioni Policor “Jugu” në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	14.3.2025
19	Qendra e Shëndetit Mendor, Podujevë	Vizitë e përgjithshme	20.3.2025
20	Qendra e Mbajtjes për të Huajt, Vranidoll	Vizitë e përgjithshme e përbashkët me UNHCR-në dhe CRPK-në	25.3.2025
21	Qendra e Përkohshme e Pritjes, Vranidoll	Vizitë e përgjithshme e përbashkët me UNHCR-në dhe CRPK-në	25.3.2025

22	Klinika Psikiatrike	Vizië ad-hoc	1.4.2025
23	Qendra për Punë Sociale në Podujevë	Vizitë ad-hoc	2.4.2025
24	Stacioni Policor “Veriu” në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	3.4.2025
25	Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” - Prishtinë	Vizitë monitoruese e kthimit me forcë	8.4.2025
26	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë	Vizitë e përgjithshme	10.4.2025
27	Stacioni Policor në Gjakovë	Vizitë e përgjithshme	14.4.2025
28	Qendra e Shëndetit Mendor në Gjakovë	Vizitë e përgjithshme	14.4.2025
29	Shtëpia Integruese në Gjakovë	Vizitë e përgjithshme	14.4.2025
30	Reparti Psikiatrik - Spitali “Isa Grezda” në Gjakovë	Vizitë e përgjithshme	14.4.2025
31	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë e përgjithshme	23.4.2025
32	Qendra e Shëndetit Mendor, Ferizaj	Vizitë e përgjithshme	28.4.2025
33	Shtëpia Integruese në Bashkësi, Ferizaj	Vizitë e përgjithshme	28.4.2025
34	Shtëpia me Bazë në Komunitet, Ferizaj	Vizitë e përgjithshme	28.4.2025
35	Qendra e Paraburgimit në Pejë	Vizitë ad-hoc	19.5.2025
36	Qendra e Ndalimit në Pejë	Vizitë përcjellëse	19.5.2025
37	Spitali i Psikiatrisë në Pejë	Vizitë e përgjithshme	19.5.2025
38	Dhomat e burgut në Repartin e Kirurgjisë në Spitalin Regjional të Pejës	Vizitë e përgjithshme	19.5.2025
39	Klinika Psikiatrike	Vizitë ad-hoc	23.5.2025
40	Stacioni Policor Malishevë	Vizitë e përgjithshme	26.5.2025
41	Stacioni Policor Rahovec	Vizitë e përgjithshme	26.5.2025
42	Qendra e Ndalimit në Prizren	Vizitë përcjellëse	28.5.2025
43	Qendra e Paraburgimit në Prizren	Vizitë e përgjithshme	28.5.2025
44	Klinika e Psikiatrisë në Prizren	Vizitë e përgjithshme	28.5.2025
45	Dhomat e burgut në Repartin e Kirurgjisë dhe Internos në Spitalin Regjional të Prizrenit	Vizitë e përgjithshme	28.5.2025
46	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	19.6.2025

47	Qendra e Mbajtjes për të Huajt, Vranidoll	Vizitë ad-hoc	01.7.2025
48	Spitali i Përgjithshëm - Reparti i Psikiatrisë në Gjilan	Vizitë e përgjithshme	07.7.2025
49	Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	08.7.2025
50	Stacioni Policor Suharekë	Vizitë ad-hoc	11.7.2025
51	Qendra Korrektuese për të Mitur dhe Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan	Vizitë ad-hoc	16.7.2025
52	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	21.7.2025
53	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	22.7.2025
54	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë ad-hoc	23.7.2025
55	Qendra e Paraburgimit në Pejë	Vizitë ad-hoc	2.8.2025
56	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	5.8.2025
57	Qendra Korrektuese për Femra, Lipjan	Vizitë ad-hoc	7.8.2025
58	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	15.8.2025
59	Qendra për Azilkërkues, Magure	Vizitë e përgjithshme	4.9.2025
60	Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” - Prishtinë	Vizitë monitoruese e kthimit me forcë	4.9.2025
61	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	10.9.2025
62	Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” - Prishtinë	Vizitë monitoruese e kthimit me forcë	9.10.2025
63	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	14.10.2025
64	Qendra Korrektuese për Femra, Lipjan	Vizitë ad-hoc	14.10.2025
65	Qendra e Paraburgim në Gjilan	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
66	Stacioni Policor në Gjilan	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
67	Stacioni Policor në Kamenicë	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
68	Shtëpia me Bazë në Komunitet në Kamenicë	Vizitë ad-hoc	17.10.2025
69	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	21.10.2025

70	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë ad-hoc	30.10.2025
71	IPFK -Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	31.10.2025
72	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	14.11.2025

Raportet me Rekomandime të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës gjatë vitit 2025

Nr.	Emri dhe data e raportit	Rekomandimet
1	AVOKATI I POPULLIT RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR	1. Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në SPMK - Jarine. 2. Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Pikëkalimin Kufitar Dheu i Bardhë.

	PARANDALIMIN E TORTURËS lidhur me vizitat në pikëkalimet kufitare dhe në stacionet policore për mbikëqyrje, si në vijim: • Pikëkalimi Kufitar “Kulla” • Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Radac • Pikëkalimi Kufitar në Merdare • Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Jarine • Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër në Kllokot • Pikëkalimi Kufitar Stanqiq – Bellanoc • Pikëkalimi Kufitar në Vërmicë • Pikëkalimi Kufitar Dheu i Bardhë 05/03/2024	- Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Pikëkalimin Kufitar Merdare. - Të sigurohet një furnizim i qëndrueshëm dhe i rregullt me tonerë dhe materiale të nevojshme për operimin e pajisjeve të fotokopjimit, printimit dhe të ketë mbështetje teknike të vazhdueshme për riparimin e printerëve dhe fotokopjuesve në të gjitha pikëkalimet kufitare dhe në stacionet policore të vizituara. Gjithashtu, të vlerësohet performanca e kompanisë, e angazhuar për mirëmbajtjen e fotokopjeve. - Të angazhohen zyrtare policore në Pikëkalimin Kufitar Merdare. - Shtim i stafit të ri policor në të gjitha pikëkalimet kufitare. - Furnizimi i menjëhershëm me uniforma të reja për zyrtarët policorë në të gjitha pikëkalimet kufitar dhe në stacionet policore. - Rikthimi në funksion i dhomave të ndalimit në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër, në Kllokot. - Të sigurohen automjete të reja dhe funksionale në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër, në Kllokot. - Sigurimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të rregullt për zyrtarët policorë në Pikëkalimin Kufitar në Vërmicë. - Sigurimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të rregullt për zyrtarët policorë në Pikëkalimin Kufitar Dheu i Bardhë. - Të funksionalizohen kamerat e sigurisë në dhomat e ndalimit në Pikëkalimin Kufitar në Vërmicë. - Hapësirat e mbajtjes (ndalimit) në pikëkalimet kufitare të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme (broshura dhe poster), përmes të cilave personat e ndaluar njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për të kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. - Pikëkalimi Kufitar në Kullë të ketë një sistem të plotë dhe të standardizuar për regjistrimin e të dhënave të personave të ndaluar. - Të gjendet zgjidhje për furnizim me të qëndrueshëm me ushqim në të gjitha pikat e kalimit kufitar.
2	AVOKATI I POPULLIT	Të punësojë staf në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Rregullores për Organizimin e


	RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS për vizitën në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë 16/04/2025	Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme. 2. Të miratojë Udhëzuesin për funksionimin e rregullave të brendshme të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Vendimit Nr. 0490/2022, të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 24 qershor 2022. 3. Ta angazhojë një infermier për nevojat mjekësore për migrantët në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë. 4. Të organizojë trajnime të nevojshme në fushën e migrimit, pasi Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë është vija e parë për strehimin e migrantëve.
3	AVOKATI I POPULLIT RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS lidhur me vizitën në Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë 05/08/2025	1. Të monitorohet zbatimi i politikave për shëndet mendor, si dhe të sigurohet që shërbimet që ofrohen respektojnë plotësisht dinjitetin dhe të drejtat e personave me probleme mendore. 2. Të zhvendoset QShM-ja e Podujevës në një objekt të përshtatshëm sipas marrëveshjes së mirëkuptimit me shkrim mes ShSKUK-së dhe Komunës së Podujevës. 3. T'u mundësohet qëndrimi ditor personave me probleme mendore të Komunës së Podujevës dhe të krijohen kushtet adekuate për ofrimin e shërbimeve në mënyrë konfidenciale.
4	AVOKATI I POPULLIT RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë 06/08/2025	1. T'i përmirësojë kushtet e jetesës për të burgosurit e akomoduar në këtë qendër, në kuptim të hapësirës dhe të kushteve të akomodimit (sigurimi i dollapëve), në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së. 2. Të krijohen kushte pune adekuate për personelin korrektues në QPM. 3. Të burgosurve t'u sigurohet ushqim cilësor dhe i mjaftueshëm, si dhe ushqim dietal sipas rekomandimit të mjekut. 4. Të krijohen hapësira të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve mjekësore nga psikiatri, stomatologu dhe psikologu, pasi të njëjtën hapësirë e shfrytëzojnë të gjithë. 5. Të shtohen më shumë aktivitete jashtë qelisë për rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve, në pajtim me LESP-në dhe me Kodin e Procedurës Penale, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

		6. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që kohëzgjatja e telefonatave të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi. 7. Të bëhen përpjekje në mënyrë që të funksionalizohet SKYPE, për t'ua mundësuar shtetasve të huaj që janë në vuajtje të dënimit komunikimin me familjet e tyre, kur nuk kanë mundësi për telefonatë apo për vizitë. 8. Të burgosurve shqiptarë në QPM t'u ofrohen shërbimet mjekësore dhe psikologjike në gjuhën të cilën ata e kuptojnë. 9. Të sigurohet ruajtja e konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore për të burgosurit e akomoduar në këtë qendër, duke garantuar që shërbimet e ofruara nga mjeku, psikologu dhe stomatologu të kryhen në hapësira të veçanta dhe pa praninë e zyrtarëve korrektues.
5	AVOKATI I POPULLIT RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS lidhur me vizitat në stacionet policore • Qendrën Rajonale të Mbjtjes në Prishtinë • Stacionin Policor në Mitrovicë – Veri • Stacionin Policor në Zveçan • Stacionin Policor në Leposaviq • Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë • Stacionin Policor “Veriu” në Prishtinë • Stacionin Policor në Gjakovë • Stacionin Policor në Malishevë	1. Të sigurohet furnizim i rregullt dhe i mjaftueshëm me uniforma për të gjithë zyrtarët policorë. 2. Të garantohet furnizim i rregullt dhe i mjaftueshëm me materiale higjienike dhe të përmirësohen kushtet e higjienës. 3. Të pajisen me pajisje funksionale për fotokopjim dhe printim, të kenë furnizim të mjaftueshëm me tonerë dhe materiale përkatëse, si dhe të sigurohet mirëmbajtja e rregullt teknike e këtyre pajisjeve. 4. Të mbahen trajnime adekuate për stafin policor për trajtimin e personave të ndaluar me sëmundje mendore. 5. Në të gjitha dhomat/qelitë në qendrat e ndalimit të vendosen në mure kartat për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar. 6. Të bëhet furnizimi me pajisje bazike IT (PC) në Stacionin Policor “Jugu” – Prishtinë. 7. Të krijohen hapësira të dedikuara për qëndrimin afatshkurtër të personave të ndaluar, për të shmangur qëndrimin në hapësira pune në Stacionin Policor “Jugu” – Prishtinë. 8. Të krijohen hapësira të dedikuara për qëndrimin afatshkurtër të personave të ndaluar, për të shmangur qëndrimin në hapësira pune në Stacionin Policor “Veriu” – Prishtinë. 9. Të rritet numri i mjeteve të transportit për t'i përmbushur nevojat operative të Stacionit Policor “Veriu” – Prishtinë. 10. Të bëhet funksionalizimi i të gjitha dhomave të ndalimit dhe të sigurohen kamera funksionale në të

	• Stacionin Policor në Rahovec • Stacionin Policor në Prizren 27/10/2025	gjitha hapësirat e Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Gjakovës. 11. Të ndërmerren veprime për renovime në objektin ekzistues për t'i përmirësuar kushtet e punës në Stacionin Policor të Gjakovës. 12. Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të Stacionit Policor të Gjakovës, për t'i shmangur defektet. 13. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të mënjanoen problemet dhe të funksionalizohet Qendra e Ndalimit në Stacionin Policor në Malishevë. 14. Të rritet numri i mjeteve të transportit për të përmbushur nevojat operative të Stacionit Policor të Rahovecit. 15. Të rritet numri i stafit policor në Stacionin Policor të Prizrenit, për t'i mbuluar ndërrimet e punës në mënyrë adekuate. 16. Në Stacionin Policor të Prizrenit të sigurohet ndërtimi i banjave brenda dhomave të ndalimit, në përputhje me standardet për trajtimin e personave të privuar nga liria. 17. Të rritet numri i psikologëve klinikë, pra të ketë shërbime psikologjike në çdo regjion të Kosovës duke u mundësuar edhe kushtet për kryerjen e detyrave profesionale.
6	AVOKATI I POPULLIT RAPORT I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS për vizitën në Qendrën e Azilit në Magure, Lipjan 27/10/2025	1. Të ndërmerren veprimet e nevojshme për mënjanimin e dëmtimeve dhe renovimin e dhomave që aktualisht janë jashtë funksionit. 2. Të ndërmerren veprime duke i vendosur familjet në një hapësirë të veçantë dhe të përshtatshme që garanton privatësi, siguri dhe një ambient të favorshëm për zhvillimin e fëmijëve dhe familjes. 3. Të punësojë staf në Qendrën e Azilit, sipas kërkesave të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga 6 raportet e publikuara, janë adresuar 51 rekomandime, prej të cilave 14 janë të implementuara, 10 pjesërisht të implementuara dhe 27 janë në pritje për implementim.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve



Nga 51 rekomandime të adresuara gjatë vitit 2025, kemi pranuar përgjigje për të gjitha rekomandime.